

# Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile

## RAPORTI PËR KOSOVË 2016



Ky projekt është financuar nga Bashkimi  
Europian nëpërmjet Instrumentit të BE-së  
për Ndhmën e Para-antarësimit (IPA)  
Instrumentit për Shoqëri Civile (CSF)



**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky Raport i Monitorimit është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis i shoqërisë civile në Ballkan - Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim”.

**Partner udhëheqës:**

Rrjeti Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN)

Metropolit Teodosij Gologanov 39/II-2, 1000-Shkup, Maqedoni

Tel.: +389 (0)2 614 42 11

[www.balkancsd.net](http://www.balkancsd.net)

**Partner zbatues për Kosovë:**

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Fazli Greiçevci 55, 10000, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 248 636; 248 643

[www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

Ky raport është shkruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile dhe ekipi përgjegjës i përbërë nga:

Taulant Hoxha – autor

Nart Orana – hulumtues i ri

Mirjeta Ademi – ndihmës hulumtuese

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit European, Trustit Ballkanik për Demokraci dhe Sida's. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European, Trustit Ballkanik për Demokraci apo Sida's.

@KCSF, 2017



BALKAN  
CIVIL  
SOCIETY  
DEVELOPMENT  
NETWORK



**CENZURA  
PLUS**



**Acquis e shoqërisë civile të Ballkanit  
Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim  
dhe monitorim  
Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për  
zhvillim të shoqërisë civile**

**RAPORTI PËR Kosovën 2016**



**B | T | D**

**The Balkan Trust  
for Democracy**

**A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND**

**Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian**

# Përmbajtja

---

Përmbledhje ekzekutive .....	4
1. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë .....	4
2. Të gjeturat kryesore.....	5
3. Rekomandimet kryesore të politikave .....	6
4. Rreth rojektit dhe Matricës së Monitorimit.....	7
Hyrje .....	8
2. Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillimin të shoqërisë civile .....	9
Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZSHHC) në Kosovë .....	10
Karakteristikat dhe Sfidat Specifike rreth aplikimit të Matricës në Kosovë.....	13
Falënderime dhe mirënjohje .....	13
Metodologjia .....	15
Pasqyra Përmbledhëse e Qasjes Metodologjike.....	15
Pjesëmarrja e OShC've .....	16
Mësimet e nxjerra.....	16
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	18
Fusha 1: Garancitë Themelore Ligjore të Lirive .....	18
Nën-fusha 1.1.: Liria e Asociimit.....	18
Nën-fusha 1.2.: Liritë tjera.....	21
Fusha 2: Korniza për Zbatueshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare të OShC'së .....	23
Nën-fusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OShC'të dhe Donatorët e tyre .....	23
Nën-fusha 2.2.: Mbështetja Institucionale.....	24
Nën-fusha 2.3.: Burimet Njerëzore.....	28
Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OShC .....	30
Nën-fusha 3.1.: Korniza dhe Praktikat për Bashkëpunim .....	30
Nën-fusha 3.2.: Përfshirja në Procesin e Politikëbërjes dhe Vendim-marrjes .....	32
Nën-fusha 3.3.: Bashkëpunimi në Ofrimin e Shërbimeve .....	35
Shtojca 1 – Burimet e shfrytëzuara .....	37
Shtojca 2 – Lista e të intervistuarve.....	39

# Përmbledhje ekzekutive

## 1. Shoqëria civile dhe zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë

Pavarësisht nga situata e vështirë politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë, shoqëria civile ka arritur të bëhet një faktor i rëndësishëm në demokratizimin e vendit. Ky ndikim shtrihet në dy nivele kryesore: së pari përmes detyrimit për transparencë dhe përgjegjësi të institucioneve publike dhe kontribuimit me ekspertizë nga OShC'të e specializuara në fusha të ndryshme dhe së dyti përmes ngritjes së çështjeve të rëndësishme sociale dhe punës me grupet qytetare prej OShC've lokale, duke i angazhuar qytetarët që t'i zgjidhin problemet e tyre të përditshme. Ndonëse niveli i angazhimit qytetar në sektor mbetet i ulët, shoqëria civile vazhdon të jetë një ndër sektorët më të besueshëm në Kosovë.

**Korniza bazike ligjore** për themelimin, regjistrimin dhe punën e OJQ've ka mbetur e pandryshuar, ndërsa gjatë vitit 2016 ka filluar një proces i ndryshimit të ligjit bazik për OJQ'të. Legjislacioni sekondar për regjistrimin dhe punën e OJQ've i miratuar gjatë vitit 2014 që përfshin dispozita kufizuese për OJQ'të mbetet në fuqi, ndërsa gjatë vitit 2016 dy grupe të OShC've u pezulluan nga Departamenti i OJQ've me pretekst se kishin vepruar kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. OShC'të vazhdojnë lirshëm që të **kërkojnë dhe sigurojnë fonde** prej burimeve të ndryshme vendore dhe të jashtme. Pjesa kryesore e kufizimeve të Ligjit mbi parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është shfuqizuar. Meqenëse **liria e tubimit** është e garantuar me ligj, OShC'të vazhdojnë t'i shfrytëzojnë lirshëm këto të drejta. Megjithatë, përçindja e OShC've që angazhohen për të organizuar dhe marrë pjesë nëpër tubime vazhdon të jetë e ulët. **Stimulimet tatimore** për donatorë privat nuk kanë ndryshuar gjatë vitit 2016, mirëpo praktikisht nuk ka të dhëna që dëshmojnë për ndonjë efekt pozitiv. Qeveria ka miratuar një model për **financim publik të OShC've**, ndërsa ka nisur përpilimi i rregullores qeveritare për financim publik të OShC've. Megjithatë, derisa kjo rregullore të jetë miratuar dhe zbatuar, fondet publike për OShC'të vazhdojnë të shpërndahen pa ndonjë kriter të qartë. Nuk është vërejtur ndonjë përmirësim sa i përket përfshirjes së shoqërisë civile në **politikat e punësimit**, ndërsa kjo vlenë gjithashtu edhe për **punën vullnetare**. Sidoqoftë, në rast kërkese, disa të dhëna rreth punësimit në shoqërinë civile janë vënë në dispozicion nga disa institucione publike. Me pak progres në pjesëmarrje dhe financim publik të OShC've, **Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile** shënoi rezultatet e para konkrete. Megjithatë, shumica nga kjo e fundit u bazua në kontributin e shoqërisë civile e jo nga buxheti i zotuar për zbatim apo nga burimet e nevojshme njerëzore për kordinim të cilat nuk u caktuan nga Qeveria. Gjatë vitit 2016 është miratuar nga Qeveria një Rregullore e re për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik dhe kjo do të hyjë në fuqi prej datës 1 Janar të vitit 2017. Ndërkohë, zbatimi i **konsultimit publik** mbetet me shumë sfida. Pjesëmarrja e OShC've në trupat ndërsektoriale mbetet e pjesëshme, me disa raste të përzgjedhjes së hapur dhe transparente. Megjithëse korniza e përgjithshme ligjore për ofrimin e shërbimeve nuk është kufizuese, në praktikë **ofrimi i shërbimeve nga OShC'të** është ende i kufizuar për disa shërbime të caktuara sociale, dhe nuk ka financim, procedura dhe standarde të duhura që do të krijonin një mjedis mbështetës për përfshirjen e OShC've në ofrimin e shërbimeve.

Ekzistojnë sfida të shumta në aspektin e fushave të ndryshme të krijimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile në të ardhmen, prej të cilave disa janë vendimtare për t'u trajtuar

në vitin pasues përfshirë: përfundimin e procesit të ndryshimit të Ligjit për OJQ'të sipas rekomandimeve të shoqërisë civile dhe standardeve e praktikave më të mira ndërkombëtare (duke përfshirë ndalimin absolut me ligj të mundësisë për të pezulluar OJQ'në nga një organ administrativ); avancimin e formateve të raportimit financiar për OShC'të, jo vetëm për të trajtuar nevojat e veçanta të sektorit por gjithashtu për të shërbyer si një burim i i saktë dhe i besueshëm i informacionit për gjendjen financiare të sektorit; ofrimin e të dhënave sistematike mbi sektorin e shoqërisë civile nga ana e institucioneve përkatëse (Agjencia e Statistikave, Administrata Tatimore, Banka Qendrore, Trusti Pensional, etj); kompletimin e kornizës rregullative rreth financimit publik për OJQ'të dhe fillimin e zbatimit të saj; detyrimin për zbatim të Rregullores mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik dhe sigurimin që nëpunësit civil të kenë kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar kërkesat.

## 2. Të gjeturat kryesore

Në vazhden e angazhimeve domethënëse të shoqërisë civile në proceset e ndryshme të politikëbërjes gjatë vitit të kaluar, viti 2016 u karakterizua me miratimin e një sërë dokumentesh të rëndësishme për ambientin ku edhe vepron shoqëria civile. Këtu bëhet fjalë për fushat e konsultimit dhe financimit publik, por gjithashtu edhe për rregulloren e shpëlarjes së parave. Nga ana tjetër, kanë filluar proceset e reja të politikëbërjes ku ndryshimi i Ligjit për Lirinë e Asocimit në OJQ zë vendin më të rëndësishëm. Ky proces i ndryshimit vazhdon paralelisht me ciklet e pezullimeve të OJQ've bazuar në shkaqe sigurie, pra është një ndërhyrje e drejtpërdrejtë shtetërore në çështjet e brendshme të OJQ've.

Nr	6 të gjeturat kryesore të raportit	Referimi në Matricën e Monitorimit		Referimi në Udhëzimet e BE-së për ShC	
		Fusha		Objektivi	
1	Megjithëse të izoluar, rastet e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë shtetërore në çështjet e brendshme të OShC've kanë vazhduar përmes pezullimit të një grupi të OShC've në Korrik dhe Nëntor të viti 2016.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1.a – 1.1.b
2	Pjesa kryesore e dispozitave kufizuese për OJQ'të është shfuqizuar me Ligjin e ri për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1.a – 1.1.b
3	Një model i financimit publik për OShC'të është miratuar nga Qeveria në Maj të vitit 2016 dhe ka filluar procesi i hartimit të rregullores së domosdoshme.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-fusha	2.2	Rezultati	2.4.a – 2.4.b
4	Në rast kërkesë, disa të dhëna rreth punësimit në shoqërinë civile janë vënë në dispozicion nga disa institucione publike.	Fusha	2	Objektivi	1
		Nën-fusha	2.3	Rezultati	1.2.a – 1.2.b
5	Qeveria nuk caktoi as buxhetin e zotuar për zbatim e as burimet e mjaftueshme njerëzore për koordinim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-fusha	3.1	Rezultati	3.1.b
6	Rregullorja mbi Standardet Minimale për procesin e Konsultimit Publik është miratuar nga Qeveria në Prill të vitit 2016 dhe hyn në fuqi që nga 1 Janari i vitit 2017.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-fusha	3.2	Rezultati	3.1.a

### 3. Rekomandimet kryesore të politikave

Përderisa një mori fushash kanë nevojë për përmirësim në legjislacion dhe mekanizma, pjesës tjetër i nevojiten zbatimi i duhur i rregulloreve tashmë të miratuara. Përmirësimet domethënëse në kornizën rregulluese në kuadër të fushave të konsultimit publik dhe financimit publik mund të jenë të qëndrueshme vetëm nëse garantohen kapacitetet dhe burimet e mjaftueshme nga ana e qeverisë. Nga ana tjetër, problemet që kanë të bëjnë me ndërhyrjet shtetërore në çështjet e brendshme të OJQ've nuk ofrojnë ndonjë bazë premtuese për reforma më komplekse në aspektin e krijimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile. Në veçanti, përpjekjet e vazhdueshme në hartimin e legjislacionit mbështetës dhe në sigurimin e zbatimit të duhur në realitet mbeten një sfidë e madhe për të dy sektorët, për shkak të numrit të kufizuar të institucioneve/OSHC've që ballafaqohen me fushat përkatëse.

Nr	6 rekomandimet kryesore për reformë	Referimi në Matricën e Monitorimit		Referimi në Udhëzimet e BE-së për ShC	
		Fusha		Objektivi	
1	Ligji i ndyshuar për Lirinë e Asocimit në OJQ do të duhej të ndalonte në mënyrë absolute pezullimin e OJQ've nga një organ administrativ, duke parandaluar kështu ndërhyrjen e vazhdueshme shtetërore në çështjet e brendshme të OJQ've. Pavarësisht nga ajo që u përmend më lartë, Neni 18 i Rregullores për regjistrimin e OJQ've i cili mundëson pezullimin e OJQ've nga Departamenti për OJQ do të duhej të shfuqizohej menjëherë.	Fusha	1	Objektivi	1
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	1.1.a – 1.1.b
2	Formatet dhe procedurat e raportimit financiar dhe tatimor për OJQ'të do të duhej të rishikoheshin për të trajtuar kërkesat e veçanta të sektorit si dhe për të shërbyer si një burim i sigurtë i informacionit rreth gjendjes financiare të sektorit.	Fusha	1	Objektivi	2
		Nën-fusha	1.1	Rezultati	2.1.a
3	Rregullorja tashmë e inicuar mbi Financimin Publik për OJQ'të duhet të finalizohet dhe miratohet në mënyrë që të rregullohet i tërë cikli i financimit publik për OJQ'të. Pavarësisht nga ajo që u përmend më lartë, i gjithë informacioni rreth financimeve publike që i dedikohet OShC've do të duhej të bëhej menjëherë transparent.	Fusha	2	Objektivi	2
		Nën-fusha	2.2	Rezultati	2.4.a – 2.4.b
4	Institucionet publike duhet të inicojnë grumbullimin, përpunimin dhe publikimin sistematik të të dhënave specifike dhe relevante për sektorin e shoqërisë civile.	Fusha	2	Objektivi	1
		Nën-fusha	2.3	Rezultati	1.2.a – 1.2.b
5	Qeveria duhet të ndajë menjëherë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e aktiviteteve të mbetura të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, si dhe të garantojë pjesëmarrjen dhe angazhimin e mjaftueshëm të nëpunësve civil në zbatimin e aktiviteteve përkatëse.	Fusha	3	Objektivi	1
		Nën-fusha	3.1	Rezultati	3.1.b
6	Paralelisht me sigurimin e zbatimit të duhur të Rregullores mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik, Qeveria do të duhej që të institucionalizonte programin e vazhdueshëm për ngritjen e kapaciteteve për nëpunësit civil në këtë fushë.	Fusha	3	Objektivi	3
		Nën-fusha	3.2	Rezultati	3.1.b

#### **4. Rreth rojektit dhe Matricës së Monitorimit**

Ky Raport monitorues është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis e Shoqërisë Civile të Ballkanit - Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim.” që u financua nga Bashkimi Europian (BE) dhe Trusti Ballkanik për Demokraci (BTD). Ky Raport monitorues është i pari i këtij lloji dhe publikohet në baza vjetore që nga viti 2013. Monitorimi bazohet në Matricën e monitorimit mbi krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile të krijuar nga BCSDN dhe ECNL. Është pjesë e një sërë raportesh vendore që përfshijnë 7 shtete të Ballkanit Perendimor dhe Turqinë<sup>1</sup>. Gjithashtu në dispozicion është Raporti Monitorues Rajonal i cili përmbledhë konkluzionet dhe rekomandimet për të gjitha vendet dhe platformën e internetit që ofron qasje në të dhënat monitoruese për atë vend dhe nën-fushë në [www.monitoringmatrix.net](http://www.monitoringmatrix.net).

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore që janë identifikuar si vendimtare për të ekzistuar në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për funksionimet e OShC've. Matrica është e sistemuar rreth tri fushave, secila e ndarë në nën-fusha: (1) Garancitë themelore ligjore të lirive; (2) Korniza për Zbatueshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare të OShC've dhe (3) Marrëdhënia Qeveri-OShC. Parimet, standardet dhe treguesit janë formuluar duke marrë parasysh gjendjen aktuale të zhvillimit në shtetet e Ballkanit Perendimor dhe Turqi dhe shumëllojshmërinë e tyre. Këto mbështeten në liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe në praktikën më të mira rregullative në nivel të Bashkimit Evropian dhe në shtetet e Evropës. Matrica synon që të përcaktojë situatën e favorshme që i përshtatet shoqërisë civile për të funksionuar dhe për t'u zhvilluar në mënyrë efektive dhe njëkohësisht synon që të krijojë një kornizë reale e cila mund të aplikohet dhe zbatohet nga autoritetet publike. Duke pasur parasysh që sfidat kryesore qëndrojnë në zbatim, treguesit përcaktohen për të monitoruar gjendjen në nivel të kornizës ligjore dhe aplikimit praktik.

---

<sup>1</sup> Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.



# Hyrje

## 1. Rreth raportit të monitorimit

Përmes një procesi pjesëmarrës që përfshinte personalitete të dalluara të shoqërisë civile, institucioneve publike, akademisë, sektorit privat dhe mediave, në vitin 2010 KCSF definoi sektorin e shoqërisë civile në Kosovë si “*hapësira shoqërore, jashtë familjes, shtetit, dhe tregut, e cila është krijuar nga veprimet individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet*”<sup>2</sup>. I aplikuar që atëherë në të gjitha studimet e KCSF’së rreth shoqërisë civile, ky përkufizim shfrytëzohet gjithashtu edhe për përcaktimin e fushëveprimit të këtij raporti monitorues që nga zanafilla e vet në vitin 2013.

Në terma konkrete, shoqëria civile në Kosovë përbëhet kryesisht prej organizatave të regjistruara jo-qeveritare (OJQ’të), ndërsa format e tjera të shoqërisë civile nuk janë të rëndomta. Shpjeguar në shifra, pavarësisht 9,000 OJQ’ve të regjistruara dhe disa iniciativave tjera të paregjistruara, numri i OShC’ve aktive në Kosovë llogaritet të jetë rreth 1,500. Më pak se 1,000 OShC kanë pasur ndonjë aktivitet financiar apo të punësuar gjatë vitit 2015. Shumica e sektorit përbëhet prej OShC’ve të vogla në aspektin e financimit dhe personelit. OShC’të me seli në Prishtinë dhe në qendrat tjera rajonale të Kosovës e dominojnë sektorin. Trendi i regjistrimit të OJQ’ve të reja ka qenë i qëndrueshëm gjatë gjashtë viteve të fundit, me rreth 500 OJQ të reja të regjistruara çdo vit.<sup>3</sup> Përveç kësaj, megjithëse formalisht qëndrojnë në kuadër të fushëveprimit të përkufizimit të shoqërisë civile, sindikatat e punëtorëve në Kosovë rrallë konsiderohet si të tilla, ndërsa bashkëpunimi midis sindikatave të ndryshme të punëtorëve dhe pjesëve tjera të shoqërisë civile është i kufizuar, ku sindikatat e punëtorëve rrallë bëhen pjesë e iniciativave dhe forumeve të shoqërisë civile. Komunitetet fetare, në përgjithsi, nuk konsiderohen si pjesë e shoqërisë civile Kosovare. Media mbetet si brenda ashtu edhe jashtë sektorit – shumica prej tyre janë të regjistruara si biznese private, mirëpo roli i tyre në çështjet specifike të demokracisë mund të konsiderohet si pjesë e shoqërisë civile<sup>4</sup>.

Ky raport ka trajtuar çështjet e shoqërisë civile në fushëveprimin e përcaktuar më lartë, ndërsa si bazë kryesore merren OJQ’të e regjistruara në Kosovë. Sidoqoftë, janë marrë parasysh iniciativat dhe çështjet e caktuara të cilat nuk përfshihen drejtpërdrejtë përbrenda shoqërisë civile, në raste kur ato iniciativa apo çështje kanë ndikuar në masë të madhe në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Ky raport mbulon zhvillimet gjatë vitit 2016 duke përfshirë të dhënat kryesore të grumbulluara gjatë periudhës së fundit të vitit 2016.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të përforcojë bazën për monitorim dhe avokim rreth çështjeve që kanë të bëjnë me krijimin e mjedisit të favorshëm dhe të qëndrueshëm të shoqërisë civile në nivel rajonal dhe vendor dhe të përforcojë strukturat për integrim dhe pjesëmarrje të OShC’ve në politikat e BE’së dhe në procesin e aderimit në nivel Evropian dhe vendor.

<sup>2</sup> CIVICUS Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovë 2011, KCSF 2011

<sup>3</sup> Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, KCSF 2016

<sup>4</sup> Matrica e Monitorimit mbi Krijimin e Mjedisit të Favorshëm për Zhvillimin e Shoqërisë – Raporti për Kosovën 2013, KCSF 2013

## 2. Matrica e monitorimit për ambientin e favorshëm për zhvillimin të shoqërisë civile

Ky Raport Monitorues është pjesë e aktiviteteve të projektit “Acquis e Shoqërisë Civile të Ballkanit - Fuqizimi i potencialit dhe kapaciteteve të OShC-ve për avokim dhe monitorim” që u financua nga Bashkimi Europian (BE) dhe Trusti Ballkani për Demokraci (BTD). Ky Raport Monitorues është i pari i këtij lloji dhe publikohet në baza vjetore që nga viti 2013. Monitorimi bazohet në Matricën e monitorimit për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Është pjesë e një sërë raportesh vendore që përfshijnë 7 shtete të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë<sup>5</sup>. Gjithashtu në dispozicion është Raporti Monitorues Rajonal i cili përmbledhë konkluzionet dhe rekomandimet për të gjitha vendet dhe platformën e internetit që ofron qasje në të dhënat monitoruese për atë vend dhe nën-fushë në [www.monitoringmatrix.net](http://www.monitoringmatrix.net).

Matrica e monitorimit paraqet parimet dhe standardet kryesore që janë identifikuar si vendimtare për të ekzistuar në mënyrë që mjedisi ligjor të konsiderohet si mbështetës dhe favorizues për funksionimin e OShC-ve. Kjo Matricë thekson faktin se krijimi i një ambienti të favorshëm është proces kompleks që përfshin fusha të ndryshme dhe që është i varur nga disa faktorë dhe faza të zhvillimit të shoqërisë dhe sektorit të shoqërisë civile.

Kjo Matricë nuk synon që t'i përvetësojë të gjitha çështjet e krijimit të ambientit të favorshëm, por më tepër nxjerr në pah ato të cilat ekspertët kanë konstatuar të jenë më të rëndësishmet për vendin në të cilin ata veprojnë. Si rrjedhojë, standardet dhe treguesit janë formuluar duke marrë parasysh gjendjen aktuale të zhvillimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi dhe shumëllojshmërinë e tyre. Këto standarde dhe tregues janë nxjerrë nga përvojat e OShC-ve të vendeve tjera në aspektin e ambientit ligjor si dhe praktikave dhe sfidave në zbatimin e tyre. Zhvillimi i parimeve, standardeve dhe treguesve është realizuar duke marrë parasysh liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht si dhe praktikat më të mira rregullative në nivel të Bashkimit Europian dhe në shtetet e Europës.

Matrica është e sistemuar në tri fusha, secila e ndarë në nën-fusha:

1. Garancitë Themelore Ligjore të Lirive;
2. Korniza për Zbatueshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare të OShC-ve;
3. Marrëdhënia Qeveri-OShC.

Fushat përcaktohen nga parimet themelore të cilat shtjellohen më tej nga standardet specifike. Për t'ua mundësuar OShC-ve vendore, donatorëve apo palëve tjera të interesuara që të shqyrtojnë dhe monitorojnë mjedisin ligjor dhe praktikat e zbatimit të tij, standardet shpjegohen më gjerësisht përmes treguesve. Matrica e plotë është e disponueshme në [www.monitoringmatrix.net](http://www.monitoringmatrix.net).

Zhvillimi i matricës së monitorimit mbi krijimin e ambientit të favorshëm për OShC-të ishte pjesë e një përpjekjeje kolektive të ekspertëve dhe profesionistëve të OShC-ve nga rrjeti i anëtarëve dhe partnerëve të BCSDN, si dhe i mbështetjes strategjike edhe të ekspertëve të ECNL-së. Ekipi i ekspertëve i përbërë prej 11 anëtarëve përfshiu një sërë njohurish dhe përvojash specifike të sektorit jo për përfitim dhe të OShC-ve si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë praktik, duke përfshirë edhe ekspertët e 10 vendeve të Ballkanit. Puna rreth matricës përfshiu takimet e punës dhe punën përmes internetit nga ekspertë, e cila më pas u shqyrtua nëpërmjet grupeve të fokusit me palët e interesit dhe konsultimet publike. Puna rreth zhvillimit të Matricës u mbështet nga USAID, Pact. Inc dhe ICNL në kuadër të Programit për ambientin e favorshëm ligjor (LEEP)/Granti për inovacion ligjor i Trustit të Ballkanit për Demokraci (BTD)

Përveç monitorimit të detajuar dhe cilësor, viti 2015 prezantoi kodet e “semaforit” në nivel 5-gradësh të rradhitura prej kodit 1)- cenimit të ambientit në mënyrë absolute deri në (5)- krijimit të ambientit të favorshëm në tërësi dhe (0) – Nuk ka të dhëna në dispozicion/mungojnë. Sistemi u krijua për të trajtuar nevojën për komunikim vizual “të përmbledhur” dhe efektiv të konkluzioneve

<sup>5</sup> Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

dhe prezantimeve sistematike të ndryshimeve në krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile në nivel standardesh përgjatë shteteve dhe viteve. Ky sistem nuk e zëvendëson por e plotëson vlerësimin cilësor, pasi që raportet përshkruese të vendeve janë baza mbi të cilën realizohet kategorizimi. Për më tepër, futja në përdorim e sistemit kategorizues mundëson standardizimin e cilësisë së Raporteve Vendore dhe Rajonale dhe kontribuon në vlerësimin më efektiv të treguesve përmes strukturës së mjetit të Matricës së monitorimit. Përderisa elementet sasore aplikohen për të mundësuar grumbullimin e rezultateve në mënyrë teknike, përfaqësimi vizual ofrohet vetëm me emërtimet përshkruese të kategorisë. Tabela 1 paraqet kategoritë me emërtimet përshkruese të kategorisë dhe rezultateve të caktuara për secilën prej tyre, si për legjislacionin ashtu edhe për praktikë.

Kategoria/kodi	Legjislacioni	Praktika	Rezultati
<b>Cenimi i ambientit në mënyrë absolute</b>	<i>Legjislacioni është plotësisht kufizues dhe kundër standardeve të MM<sup>6</sup>. Është kufizues ndaj funksionimit të OShC've dhe përfaqësuesve të tyre dhe pengon apo vështirëson seriozisht punën e tyre.</i>	<i>Në praktikë, standardet e MM kufizohen apo cenohen rëndë, ndërsa vështirësohet funksionimi i OShC've dhe puna e përfaqësuesve të tyre. Neglizhenca dhe kufizimet janë të zakonshme, ekzistojnë kërcënimet ndaj OShC've/përfaqësuesve të tyre, gjë që ndikon në masë të madhe në punën e tyre.</i>	1
<b>Cenimi i ambientit</b>	<i>Legjislacioni është kufizues dhe nuk është në përputhje me standardet e MM. Pengon dhe vështirëson punën e OShC've dhe punën e përfaqësuesve të tyre, megjithatë lejon një hapësirë të caktuar për funksionimin e OShC've dhe punën e përfaqësuesve të tyre.</i>	<i>Në praktikë, standardet e MM janë të paplotësuara/të papërbushura. OShC'të pengohen; përballen me sfida dhe pengesa thelbësore gjatë punës së tyre, mirëpo përkundër vështirësive serioze OShC'të dhe përfaqësuesit e tyre megjithatë mund të funksionojnë.</i>	2
<b>Krijimi i ambientit të favorshëm në mënyrë të pjesërishme</b>	<i>Legjislacioni plotëson/përbushë në mënyrë të pjesërishme standardet e MM, mirëpo ende ekzistojnë disa kufizime apo çështje të vogla ligjore të cilat nuk janë rregulluar.</i>	<i>Në praktikë, standardet e MM janë të plotësuara/të përbushura në mënyrë të pjesërishme. Cenimet e rënda nuk janë të rëndomta, mirëpo raportohet për kufizime dhe vështirësi të vogla në punën e OShC've/përfaqësuesve.</i>	3
<b>Krijimi i ambientit të favorshëm</b>	<i>Legjislacioni është në përputhshmëri me standardet e MM.</i>	<i>Në praktikë, standardet e MM respektohen/përbushen. Nuk ka raste të raportuara ose të pakta janë shkeljet, kufizimet dhe pengesat ndaj punës së OShC've/përfaqësuesve të tyre.</i>	4
<b>Krijimi i ambientit të favorshëm në tërësi</b>	<i>Legjislacioni është plotësisht në përputhshmëri me standardet e MM. Madje ekzistojnë raste kur legjislacioni tejkalon standardet dhe parimet e mishëruara në MM.</i>	<i>Në praktikë, standardet e MM respektohen/përbushen në tërësi, ndërsa zbatimi i legjislacionit është një proces rutinor prej të gjitha palëve të përfshira. Ekzistojnë raste të praktikave më të mira të cilat tejkalojnë standardet dhe parimet e mishëruara në standardet e MM.</i>	5

## Shoqëria Civile dhe Zhvillimi i Shoqërisë Civile (ZSHHC) në Kosovë

OShC'të e Kosovës mbulojnë një gamë të gjërë të fushave të aktivitetit të tyre. Megjithëse nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare rreth numrit të OShC've që angazhohen në fushat specifike të aktivitetit,

<sup>6</sup> Standardet e Matricës së Monitorimit janë zhvilluar duke marrë parasysh liritë dhe të drejtat e garantuara ndërkombëtarisht dhe të mishëruara në ligjin ndërkombëtar dhe në praktikatat më të mira rregullative në nivel rajonal.

studimet e KCSF'së tregojnë se disa fusha janë duke i tërhequr vazhdimisht më shumë OShC, ndërsa fushat tjera janë duke përjetuar rënie në numër të OShC've të përfshira. Në fillim fushat kryesore të punës ishin gratë, minoritetet dhe çështjet e të rinjve. Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, OShC'të të cilat veprojnë rreth çështjeve të demokratizimit, të tilla si sundimi i ligjit në përgjithësi dhe ato që konsiderohen si interpretuese të rolit të "mbikëqyrësve" (ëatchdog) në veçanti, janë duke e rritur praninë e tyre. Të dhënat nga anketa tregojnë se kultura, barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas, demokratizimi, rinia, përkrahja e personave me aftësi të kufizuar, transparencja dhe përgjegjësia si dhe të drejtat e njeriut kanë qenë disa prej fushave ku OShC'të janë më së shumti aktive.<sup>7</sup>

Ka disa vite që qëndrimi i zyrtarëve shtetëror ndaj zhvillimit të OShC've dhe dialogut civil është zhvendosur prej një mospërfilljeje të madhe dhe bashkëpunimi të paplanifikuar, sporadik, dhe jo-transparent drejt një interesimi gradualisht në rritje dhe nevojë për të strukturuar bashkëpunimin me tërë sektorin. Zhvillimet kryesore që patën ndikim në këtë zhvendosje ishin diskutimet rreth Strategjisë Qeveritare dhe miratimit të saj për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, të cilat u shoqëruan nga një sërë dokumentesh tjera strategjike, të tilla si Deklarata e Kuvendit e vitit 2014 për partneritet me shoqërinë civile. Të gjitha këto dokumente janë përpiluar si rezultat i angazhimit dhe kontributit të shtuar nga ana e shoqërisë civile. Kjo trysni e brendshme u plotësua nga vërejtjet e vazhdueshme të Bashkimit Europian dhe organizatave tjera ndërkombëtare rreth nevojës për një sektor të zhvilluar civil, kështu kjo rezultoi në interesim të shtuar të autoriteteve shtetërore për të trajtuar formalisht mekanizmat dhe instrumentet e bashkëpunimit midis sektorëve. Megjithatë, miratimi i dokumenteve strategjike nuk shoqërohej domosdoshmërisht me angazhim të mjaftueshëm në zbatimin e zotimeve. Përkundër një numri të zhvillimeve pozitive të asaj periudhe, ende vazhdojnë të mbeten shumë sfida, në veçanti në aspektin e mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe financiare të dedikuara nga shteti për zhvillimin e shoqërisë civile si dhe vullnetit të pamjaftueshëm politik për të ndërmarrë reforma më thelbësore në këtë fushë. Kjo u vërtetua gjithashtu edhe nga Raporti i fundit për Kosovën i publikuar nga Komisioni Europian në Nëntor të vitit 2016.<sup>8</sup>

Si rrjedhojë, shumica e standardeve për një krijim të mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile akoma nuk janë përmbushur. Për disa fusha, siç është liria e asociimit, legjislati aktual në përgjithësi është pozitiv, me disa dispozita kufizuese të veçuara por serioze. Në fushat tjera, siç është përfshirja e shoqërisë civile në vendim-marrje, korniza legjislative pozitive është avancuar me instrumente më specifike të zbatimit, mirëpo zbatimi i saj do të fillojë që nga viti 2017. Ekzistojnë akoma fusha, të tilla si mbështetja institucionale e shoqërisë civile, ku korniza e politikave dhe rregullores është ende në fazën e zhvillimit.

Faktorët që pengojnë zhvillimin e OShC've rezultojnë nga të dyja anët. Para se gjithash, qytetarët e Kosovës mbeten pasiv dhe të painteresuar ndaj jetës publike në përgjithësi, duke përfshirë nivelet e ulëta të angazhimit të tyre në shoqërinë civile. Vetëm 2.9% të qytetarëve janë anëtarë të një OShC'je dhe vetëm 3.8% e tyre kanë kryer ndonjë punë vullnetare për sektorin.<sup>9</sup> Me një numër të vogël të OShC've të qëndrueshme të cilat edhe e krijojnë kërkesën e brendshme për krijimin e mjedisit të favorshëm, trysnia ndaj institucioneve publike për angazhim dhe rezultat të shtuar në krijimin e mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile mbetet i ulët. Përderisa përpjekjet e OShC've mbështeten nga Bashkimi Europian, si një akter kryesor i jashtëm që i detyron institucionet

<sup>7</sup> Anketa Organizative për vitin 2016

<sup>8</sup> Raporti i KE për Kosovën 2016, fq.9-11

<sup>9</sup> Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, KCSF 2016

shtetërore që të punojnë rreth krijimit të mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile, sektorët tjerë si, sektori privat, mbeten mënjanë. Niveli i ulët i të kuptuarit të konceptit të shoqërisë civile dhe potencialit të saj për ndërtimin e një shteti demokratik dhe funksional mbetet një faktor shumë pengues, megjithëse numri i nëpunësve civil të ekspozuar ndaj diskutimeve rreth zhvillimit të shoqërisë civile është në rritje. Problemet tjera sistematike të shoqërisë dhe shtetit të Kosovës, siç janë mangësitë në sundimin e ligjit dhe niveli i lartë i korrupsionit janë barrë shtesë që duhet tejkaluar. E fundit por shumë e rëndësishme, ka rreth tri vite që Kosova është duke kaluar përmes krizës së përsëritur politike e cila dëmton funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Në kuadër të këtij mjedisi dinamik dhe jostabil politik, zhvillimi i shoqërisë civile nuk është çështje kryesore në agjendën e vendim-marrësve.

Përderisa mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore prapa vështirësive të shumta në avancimin e mjedisit të funksionimit të OShC've, disa prej faktorëve mbeten gjithashtu si rezultat i zhvillimit historik të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në Kosovë. Historia e shoqërisë civile në Kosovë është pjesë e një historie të gjatë të Europës Lindore gjatë rënies së komunizmit, por gjithashtu kjo shoqëri u formësua nga rrethanat unike të Kosovës dhe shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Kur statusi i autonomisë së Kosovës u revokua në vitin 1989, shoqëria civile u bë pjesë e rezistencës duke bashkëpunuar ngushtë me qeverinë paralele të krijuar në kundërshtim me Beogradin dhe që ofronte shërbime alternative të shëndetësisë, mirëqenies dhe arsimit. Suksesi i Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve është vetëm një shembull i popullaritetit dhe fuqisë së shoqërisë civile gjatë kësaj epoke.<sup>10</sup> Pothuajse e gjithë popullata e Kosovës ishte aktive gjatë dekadës së plotë të solidaritetit dhe vullnetarizimit shoqëror. Shoqëria civile u përball me një ndryshim radikal pas intervenimit të NATO's në vitin 1999, me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë të fokusuar në krijimin dhe rindërtimin e paqes dhe me një fluks të donatorëve të huaj që nxitnin OShC'të që të jenë akterë të rëndësishëm, por gjithashtu ndonjëherë, rastësisht apo jo, të jenë në kundërshti me parametrat e një roli të tillë. Për pjesën më të madhe të periudhës së qeverisjes ndërkombëtare dhe administratës së dyfishtë të UNMIK'ut dhe institucioneve lokale gjatë viteve 2000, shoqëria civile më së shumti ishte e përqendruar në veprimet emergjente dhe rindërtim, si dhe në pajtim ndëretnik, duke pasur shumë pak angazhim në institucionet publike. Pasi që institucionet lokale morën përsipër përgjegjësitë, në veçanti pas pavarësisë së Kosovës, administrata e re publike dhe mungesa e përvojës në bashkëpunimin me shoqërinë civile vazhduan të paraqesin vështirësi tjera në zhvillimin e legjislacionit dhe mekanizmave të rinj, sidomos në fazën zbatuese.<sup>11</sup>

Pas çlirimit dhe pavarësisë nuk ekziston më motivi i madh politik i asaj kohe, ndërsa burimet dhe energjia e asaj periudhe janë shpenzuar prej kohësh.<sup>12</sup> Gjatë vitit 2015, kënaqshmëria e qytetarëve me drejtimin e shtetit pësoi edhe më tej rënie, duke arritur kështu nivelet më të ulëta për një kohë të gjatë. Vetëm 15.4 % të qytetarëve duket se besojnë se janë krijuar proceset demokratike në Kosovë dhe se ato janë duke shkuar në drejtim të duhur. Kënaqshmëria me punën e Institucioneve

---

<sup>10</sup> UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2008, Shoqëria Civile & Zhvillimi, fq.12, [http://development.undp.org/sites/default/files/nhdr\\_2008\\_kosovo\\_en.pdf](http://development.undp.org/sites/default/files/nhdr_2008_kosovo_en.pdf)

<sup>11</sup> Matrica e Monitorimit mbi Krijimin e Mjedisit të Favorshëm për Zhvillimin e Shoqërisë – Raporti për Kosovën 2013, KCSF 2013

<sup>12</sup> KCSF-CIVICUS, Indeksi i Shoqërisë Civile, Raport Analitik për Kosovën 2011, Qeverisje Më e Mirë për Ndikim më të Madh, Thirrje për Qytetarë, f.23, <https://civicus.org/downloads/CSI/Kosovo.pdf>

Qendrore (17.8%), Gjykatave (18.4%), Prokurorisë (16.9%), Kryetarit të Kuvendit (24.3%) dhe Presidentit (45.7%) mbetet e ulët.<sup>13</sup>

### **Karakteristikat dhe Sfidat Specifike rreth aplikimit të Matricës në Kosovë**

Çdo analizë e shoqërisë civile që bazohet në të dhëna empirike është një zotim sfidues në Kosovë, për shkak të mangësive të mëdha në të dhëna që gjenden në dispozicion të Agjencisë së Statistikave apo institucioneve tjera që janë kompetente për fushat specifike të sektorit. Kështu kishte ndodhur edhe në rastin e vlerësimit të çështjeve shtetërore në lidhje me treguesit specifik të këtij raporti, që nga zanafilla e përpilimit të tij. Sidoqoftë, si rezultat i nevojës për të grumbulluar informata për studimet e saja të rregullta, por duke qenë gjithashtu një ndër treguesit e Krijimit të Mjedisit të Favorshën të përcaktuar në Matricë, trysnia e KCSF'së për të dhëna specifike për shoqërinë civile ka arritur disa suksese. Në pjesën e parë të vitit 2016 KCSF'së j'u mundësua qasja në disa të dhëna rreth punësimit dhe financave të sektorit nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Edhe pse nuk janë gjithëpërfshirëse dhe të detajuara këto të dhëna megjithatë ofrojnë disa informacione të rëndësishme mbi strukturën dhe vlerën ekonomike të sektorit.

Në anën tjetër, pozicionimi i KCSF'së si një organizatë lidere e ZHSHC në Kosovë rezultoi me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe kontribut të KCSF'së në shumicën e zhvillimeve që kanë të bëjnë me ZHSHC. Si rrjedhojë, u grumbullua një sasi e konsiderueshme e informacionit gjatë punës së përditshme të KCSF'së drejtpërdrejtë nga stafi i saj.

E fundit por shumë e rëndësishme, pavarësisht angazhimit të OShC've tjera në kryerjen e hulumtimeve specifike mbi standardet e caktuara të kësaj Matrice, ka pasur pak elemente të shtuara që e pasurojnë raportin. Kjo ndodh kryesisht për shkak të faktit që zhvillimi i shoqërisë civile është ende një temë e re edhe për shumicën e OShC've, ndërsa vetëm disa prej tyre kanë kapacitete dhe ekspertizë të mjaftueshme për të siguruar të dhëna dhe analiza të besueshme në këtë fushë.

### **Falënderime dhe mirënjohje**

Gjatë mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për këtë raport, KCSF u bazua në punën ekipore që përfshiu pjesën kryesore të stafit të saj dhe u mbështet në rezultatet e një sërë projektesh dhe iniciativash tjera të kryera nga ana e saj. Pa mbështetjen tepër bujare të kolegëve të KCSF'së do të kishte qenë e pamundur për ekipin bërthamë përgjegjës për këtë raport që ta përfundonte këtë detyrë. Kjo është arsyeja pse kontributi i secilit anëtar të ekipit të KCSF'së është shumë i çmuar.

Përveç kësaj, KCSF do të dëshironte të shprehë mirënjohjen e saj për të gjitha ato OShC dhe përfaqësuesit e institucioneve publike dhe sektorëve tjerë të cilët kanë dhënë opinionet dhe mendimet e tyre përmes pjesëmarrjes nëpër anketa dhe përgjigjeve të ofruara gjatë intervistave. Informacioni i grumbulluar nga akterët relevant për punën e shoqërisë civile në Kosovë ishte vendimtar për të mbuluar gjithë fushëveprimin e kësaj matrice.

Së fundi, KCSF falenderon mbështetjen e ofruar nga Zyra Ekzekutive e BCSDN'së për zhvillimin dhe zbatimin e këtij studimi të monitorimit. Mbështetja e tyre ishte shumë e dobishme për të futur

---

<sup>13</sup> Raporti i Pulsit Publik. UNDP – Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. Ed. XI Prishtinë, Kosovë:UNDP, 2016, fq.4 [http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic\\_governance/public-pulse-11/](http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-11/)

gjithë informacionin përbrenda një formati të përcaktuar qartë, i cili është i krahasueshëm në nivel rajonal duke ofruar hapësirë të mjaftueshme për informacionin specifik të vendit.



# Metodologjia

## Pasqyra Përmbledhëse e Qasjes Metodologjike

Matrica është shtjelluar duke u bazuar në ekspertizën dhe përvojën rajonale dhe synon që të trajtojë çështjet e përbashkëta relevante për gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë si dhe çështjet specifike të secilit vend të përfshirë në kuadër të saj. Meqenëse zhvillimet në disa standarde të përfshira në këtë Matricë nuk janë aq gjithëpërfshirëse sa të krijohet ndonjë ndryshim në baza vjetore, është vendosur që monitorimi i të gjitha standardeve të kryhet vetëm një herë në dy vite. Me përfundimin e studimit të plotë të monitorimit për vitin 2015, monitorimi për vitin 2016 ka mbuluar vetëm 12 standarde thelbësore që konsiderohen të jenë si më të rëndësishmet, më konkretisht:

- Standardi 1.1.2: OShC'të funksionojnë lirshëm pa ndonjë ndërhyrje të pajustifikueshme shtetërore në udhëheqjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme;
- Standardi 1.1.3: OShC'të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirshëm burime financiare nga burime të ndryshme vendore dhe të jashtme për të mbështetur aktivitetet e tyre;
- Standardi 1.2.1: Përfaqësuesit e OShC've në mënyrë individuale apo përmes organizatave të tyre gëzojnë lirinë e tubimit paqësor;
- Standardi 2.1.1: Përfitimet tatimore janë të disponueshme për burime të ndryshme të të ardhurave të OShC've;
- Standardi 2.2.1: Financimi publik është i disponueshëm për zhvillim institucional të OShC've, mbështetje të projektit dhe bashkë-financim të granteve të BE'së dhe granteve tjera;
- Standardi 2.2.2: Financimi publik shpërndahe në mënyrë të përcaktuar dhe transparente;
- Standardi 2.3.1: OShC'të trajtohen në mënyrë të barabartë me punëdhënësit tjerë;
- Standardi 2.3.2: Ekzistojnë mundësitë për krijimin e politikave dhe ligjeve të vullnetarizmit;
- Standardi 3.1.2: Përmes funksionimit të institucioneve të veta shteti e pranon rëndësinë e zhvillimit dhe bashkëpunimit me sektorin;
- Standardi 3.2.1: Ekzistojnë standardet që mundësojnë përfshirjen e OShC-ve në vendimmarrje, që të ua mundëson atyre dhënien e komenteve dhe kontributit me kohë;
- Standardi 3.2.3: Përfaqësuesit e OShC've janë partnerë të barabartë në organet ndërsektoriale dhe ata përzgjidhen përmes kriteve dhe proceseve të përcaktuara qartë; dhe
- Standardi 3.3.1: OShC'të angazhohen në shërbime të ndryshme dhe konkurrojnë për kontrata të institucioneve në baza të barabarta me ofruesit tjerë.

KCSF monitoron në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet kryesore në secilin prej standardeve si pjesë e funksionimit të saj ditor përgjatë gjithë vitit. Për më tepër, duke qenë organizatë lidere në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, KCSF në mënyrë të drejtpërdrejtë merr pjesë në shumicën e iniciativave për ta avancuar legjislativonin dhe zbatimin e krijimit të mjedisit të favorshëm për shoqërinë civile. E njëjta situatë ka vazhduar të jetë edhe gjatë vitit 2016. Kjo u ka mundësuar ekipit hulumtues që hulumtimin kryesor ta përqendrojë vetëm tek ato çështje të cilat kanë pasur nevojë për informata dhe analiza të mëtejshme. Gjatë gjysëmvetorit të dytë, KCSF inicioi hulumtimin me të dhëna nga terreni i cili grumbulloi të informata për secilin nga standardet dhe treguesit thelbësor të Matricës së Monitorimit të përfshirë në raportin e vitit 2016. Grumbullimi i të dhënave u realizua përmes aplikimit të mjeteve sasore dhe cilësore të hulumtimit. Fillimisht, një mori hulumtimesh gjithëpërmbledhëse të internetit u përqendruan në identifikimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe legjislativonit të miratuar gjatë vitit 2016. Përmes hulumtimit



në internet gjithashtu u shqyrtuan raportet nga organizatat tjera që kishin të bënin me standardet e përfshira në Matricë. Në fund të vitit 2016 – fillim të vitit 2017 u realizua një anketë organizative me 101 OShC'të aktive duke aplikuar një mjet gjithëpërfshirës të anketës në internet si dhe intervistat e drejtpërdrejta me ata të cilët u përballën me vështirësi gjatë anketimit në internet. Anketa u bazua në një pyetësor të standardizuar që u aplikua nga të gjitha vendet e rajonit, me përshtatjet e domosdoshme për kontekstin e Kosovës. Modeli i Anketës së Organizatave u mbështet në listën e OJQ've të regjistruara. Për të grumbulluar informacione gjithëpërmbledhëse dhe përfaqësuese rreth sektorit, në aspektin e madhësisë, fushës së aktivitetit, viteve në sektor dhe shpërndarjes gjeografike, u aplikua metodologjia e modelimit të shtresuar përmes zgjedhjes së rastësishme. Mostra e anketës u përzgjedh duke zbatuar dy veprime: 1) Përcaktimi i objektivave për kategoritë e shtresës/objektivit: 10 OShC të mëdha dhe të qëndrueshme, 5 OShC ndërkombëtare, 5 OShC nga komuniteti Serb dhe 5 OShC nga komunitetet tjera etnike (jo-Shqiptare dhe jo-Serbe). Për të siguruar përfaqësimin gjeografik të organizatave, organizatat e shoqërisë civile gjithashtu u veçuan përgjatë rajoneve si në vijim: së paku 15 OShC nga Prishtina dhe së paku 10 OShC nga rajonet tjera kryesore të Kosovës. 2) Përzgjedhja e rastësishme e OShC've nga secila shtresë/kategori, bazuar në listën e OJQ've të regjistruara. Meqenëse ekzistenca e një OShC'je në listën e OJQ've të regjistruara jo domosdoshmërisht nënkupton që OShC'ja është aktive, shumë nga OShC'të që u përzgjedhën në raundin e parë nuk u anketuan. Si rrjedhojë, metodologjia e njejtë për përzgjedhjen e mostrës së hulumtimit u përsërit disa herë derisa u kompletua numri përfundimtar i OShC've të anketuara. Kjo u realizua duke caktuar numra të rastësishëm tek secila prej OShC've në secilën shtresë dhe duke e intervistuar, klasifikuar dhe përzgjedhur OShC'në pasuese.

Anketa u plotësua prej afërsisht pesëmbëdhjetë intervistave, me të anketuarit nga institucionet publike dhe shoqëria civile, në fushat ku mungonte informacioni specifik ose kishte nevojë për verifikim. Përzgjedhja e të intervistuarëve u bazua mbi metodën e “informatoreve kyç” të cilët u përzgjedhën në bazë të përfshirjes së tyre nëpër fusha të ndryshme të përfshira në nën-fushat specifike të kësaj Matrice, duke supozuar se ata posedojnë informacione dhe të dhëna të cilat mund të shqyrtohen nga intervistuesit. Intervistat synonin që t'i mbulonin të gjitha ato fusha për të cilat kishte nevojë për informata më specifike për t'i vlerësuar treguesit e caktuar. Secili prej të intervistuarve kishte grupe mjaft specifike të pyetjeve, varësisht prej fushës së tyre specifike të ekspertizës dhe përvojës. Intervistat u zhvilluan me shkrim apo përmes takimeve të drejtpërdrejta, varësisht prej preferencës së të anketuarëve.

### **Pjesëmarrja e OShC've**

Organizatat e shoqërisë civile janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në grumbullimin e të dhënave, si përmes metodologjisë sasiore ashtu edhe të asaj cilësore. Anketa specifike për këtë raport u zhvillua me 101 OShC aktive dhe përfshiu një gamë të gjërë temash që kishin të bënin me krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Përveç kësaj, intervistat u zhvilluan me 15 të anketuar, midis tyre gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

### **Mësimet e nxjerra**

Meqenëse është raundi i katërt i monitorimit vjetor, ka shumë pak mësimet e nxjerra nga ky proces. Më kryesorja, e që është e pranishme që disa vite përfshirë vitin 2016, është më tepër nevoja për grumbullimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të të dhënave se sa për një hulumtim të vetëm të zhvillimeve të një viti të caktuar. Kjo është dëshmuar të jetë e rëndësishme për shkak të nevojës për reagim në kohë ndaj zhvillimeve specifike të cilat kërkojnë identifikim të

menjëhershëm të problemeve dhe avokim të vazhdueshëm. Përmes raporteve të Matricës së Monitorimit që publikohen në baza vjetore, avokimi me kohë që rrjedhë prej monitorimit të vazhdueshëm ka qenë vendimtar në trajtimin e shumë çështjeve që kishin të bënin me krijimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile.

# Konkluzionet dhe Rekomandimet


## Fusha 1: Garancitë Themelore Ligjore të Lirive

### Nën-fusha 1.1.: Liria e Asociimit

Standardi 2: Ndërhyrja Shtetërore

#### Legjislacioni

Korniza ligjore ndalon autoritetet publike që të ndërhyjnë në punën dhe aktivitetet e OJQ've, përveç Neni 18 të Udhëzimit Administrativ QRK – Nr: 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e OJQ've. Në mënyrë konkrete, Neni 18 ia mundëson Departamentit për OJQ që të pezullojë veprimtarinë e OJQ'së me kërkesën me shkrim dhe arsyetimin e institucionit të autorizuar të sigurisë. Kohëzgjatja maksimale e pezullimit është një vit ndërsa arsyetimi mund të bazohet në rastet kur veprimtaritë e OJQ've dyshohen se nuk përkojnë me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare.



Shoqëria civile ka argumentuar se ky nen nuk është në përputhshmëri me legjislacionin primar dhe standardet ndërkombëtare. Sidoqoftë, ky nen mbetet ende në fuqi dhe lejon ndërhyrjen e pajustificueshme shtetërore në udhëheqjen dhe aktivitetet e OShC've. Nuk ka dispozita specifike ligjore që e obligojnë shtetin për të ofruar mbrojtje nga ndërhyrja e palëve të treta. Procesi i inicuar rishtazi për ndryshimin e Ligjit mbi Lirinë e Asociimit në OJQ është duke i trajtuar që të dyja çështjet, megjithëse ende nuk është marrë ndonjë vendim formal.

Kërkesat e raportimit për OShC'të janë të dyfishta: raportimi në Administratën Tatimore për transaksionet e tyre financiare dhe pasqyra financiare vjetore, si dhe raportimi në Departamentin e Regjistrimit të OJQ've për Organizatat me status për Përfitim Publik. Kërkesat e raportimit në Administratën Tatimore janë identike me ato të bizneseve, njësoj sikurse sanksionimi në rast të dështimit për t'i përmbushur këto kërkesa të raportimit, të cilat janë proporcionale me përmasat e OShC've/biznesit. Në anën tjetër, raportimi i OPP've (241 OPP në vitin 2016) është si përshkruar ashtu edhe financiar, ndërsa OPP'të që kanë të ardhura prej më shumë se 100,000 Euro do të duhej të paraqisnin një raport të auditimit të jashtëm.

Ligji i ri 05/L-096 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit u miratua me 16 Maj të vitit 2016. Shumica e dispozitave kufizuese të Ligjit u shfuqizuan dhe kjo ka qenë si rezultat i angazhimit intensiv të shoqërisë civile përmes grupeve punuese dhe mënyrave tjera të avokimit për shfuqizimin e dispozitave që ishin të rënda për OJQ'të. Sidoqoftë, disa dispozita të mbetura për OJQ'të nuk janë në harmoni me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë kufizimet për të pranuar donacione në para të gatshme dhe detyrimet për të financuar trajnimet për programet kundër shpëlarjes së parave dhe kryerjes së analizës së rregullt profesionale. Duke qenë masa standarde për banka dhe subjekte të qëndrueshme, këto detyrime vështirë se mund të zbatohen nga shumica e OJQ've të regjistruara, të cilat janë organizata të vogla dhe me bazë në komunitet.

Në kuadër të Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ, dispozitat ligjore rreth shpërbërjes së OJQ've janë në përputhshmëri me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Megjithatë, drafti fillestar i Ligjit të ndryshuar për OJQ, i propozuar nga qeveria, përfshin dispozita kufizuese rreth shpërbërjes së

OJQ've, në veçanti duke paraqitur dispozita që çojnë në ndërprerjen e veprimtarisë së OJQ'së pas dështimit për të raportuar rreth Statusit të Përfitimit Publik dhe detyrimeve tatimore. Përfaqësuesit e OShC've janë pjesë e grupit punues dhe kanë kërkuar shfuqizimin e këtyre dispozitave nga drafti. Pavarësisht ekzistencës së një udhëzimi administrativ mbi themelimin e Komitetit për Shpërndarjen e Aseteve të mbetura nga OJQ'ja me veprimtari të ndërprerë, procedurat dhe kriteret specifike rreth vendimeve të ndërmarra nga ky Komitet nuk janë të përcaktuara qartë.


### Praktika

Në përgjithësi, OShC'të në Kosovë vazhdojnë të veprojnë lirisht pa ndërhyrje të pajustificueshme shtetërore në udhëheqjen dhe aktivitetet e tyre të brendshme. Me përjashtim të pezullimit të një numri të OJQ've me arsyetim të sigurisë kombëtare, nuk ka raste tjera të raportuara për ndërhyrje të drejtëdrejtë shtetërore në çështjet e brendshme të OShC've. Gjatë vitit 2016 ndodhën dy raste të pezullimeve të OShC've (Korrik dhe Nëntor të vitit 2016), duke rezultuar me suspendim të 21 OJQ've. Shumica e këtyre OJQ've ishin pezulluar me vendime pezulluese njëvjeçare për të tretin vit me rradhë që nga vitit 2014. Pezullimi ishte bazuar me kërkesë të "organit kompetent për siguri" me arsyetimin "rrezikim i sigurisë dhe veprim kundër rendit kushtetues të Kosovës", bazuar në Nenin 18 të Udhëzimit Administrativ QRK – Nr: 02/2014 për Regjistrimin dhe Funkcionimin e OJQ've. Përveç arsyetimit të lartpërmendur nuk ishte ofruar ndonjë justifikim tjetër në listën e publikuar të organizatave të pezulluara. Gjatë vitit 2016 janë raportuar inspektime shumë të rralla nga ana e Administratës Tatimore, ndërsa nuk ka informacion zyrtar rreth nivelit të zbatimit të dispozitave të reja për OJQ'të nga ligji për shpërlarje të parave. Shumica dërmuese e të anketuarve të OShC've (96.04%) vërtetuan se nuk kishin përjetuar ndonjë ndërhyrje shtetërore apo të ndonjë pale tjetër në çështjet e brendshme të organizatave të tyre, përveç atyre që raportuan për ndërhyrje të tilla duke përmendur kryesisht refuzimin e institucioneve publike për të bashkëpunuar me ta apo trysninë nga zyrtarët shtetëror kundrejt personelit të tyre. Të gjitha rastet e raportuara për ndërprerje të veprimtarisë së OShC've kanë qenë vullnetare dhe Komiteti për shpërndarjen e asetëve të mbetura nuk ka qenë i detyruar që të bëhet funksional.

### *Standardi 3: Sigurimi i Burimeve Financiare*

#### Legjisllacioni

Në Kosovë OShC'të mund të kërkojnë dhe sigurojnë lirshëm burime financiare prej burimeve të ndryshme vendore dhe të jashtme për të mbështetur aktivitetet e tyre. Ndryshimet në Ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit ka qenë pozitiv ndaj punës së OShC've, me përjashtim të donacioneve me para të gatshme. Në mënyrë konkrete, ligji i ri për shpërlarjen e parave kufizon pranimin e parave të gatshme nga donatori në vlerë prej 500 Euro brenda një dite dhe 1,000 Euro brenda një viti. Pavarësisht se shumica e OShC've i kryejnë aktivitetet e tyre financiare përmes transaksioneve bankare, kjo dispozitë megjithatë është kufizuese për financimet individuale nga OJQ'të, përfshirë burimet e jashtme. Dispozitat për OJQ'të në Ligjin për Tatim në të Ardhurat e Korporatave mbeten të paqarta dhe nuk është e qartë nëse përjashtimet e tatimit standard të korporatave aplikohen tek të gjitha OJQ'të apo vetëm tek ato që kanë Status për Përfitim Publik. Pranimi i financimit të jashtëm është i lejuar. Për më tepër, OShC'të mund të pranojnë fonde




transaksioneve bankare, kjo dispozitë megjithatë është kufizuese për financimet individuale nga OJQ'të, përfshirë burimet e jashtme. Dispozitat për OJQ'të në Ligjin për Tatim në të Ardhurat e Korporatave mbeten të paqarta dhe nuk është e qartë nëse përjashtimet e tatimit standard të korporatave aplikohen tek të gjitha OJQ'të apo vetëm tek ato që kanë Status për Përfitim Publik. Pranimi i financimit të jashtëm është i lejuar. Për më tepër, OShC'të mund të pranojnë fonde

gjithashtu prej individëve, korporatave dhe burimeve tjera. Një Vendim Shpjegues Publik formal i nxjerrë nga ATK në Gusht të vitit 2016 specifikon përjashtimet e TVSH'së për të gjitha importet dhe blerjet nga OJQ'të, të paguara nga donacionet qeveritare të atyre shteteve që kanë marrëveshje dypalëshe me Kosovën, si dhe për të gjitha donacionet që mbështesin programet dhe projektet e karakterit humanitar, rindërtues dhe të Integritimit European, duke përfshirë financimet e BE'së.

## Praktika

Në praktikë, pak OShC angazhohen në aktivitetet ekonomike. Rreth 88% të OShC've të anketuara deklaruan se nuk angazhohen në aktivitete ekonomike dhe një e treta e atyre që angazhohen në aktivitetet ekonomike raportojnë se përballen me probleme të ndryshme. ATK ka bërë shumë pak për të avancuar kapacitetet e saja në ballafaqim me karakterin specifik të veprimtarisë së OShC've, ndërsa OShC'të në shumicën e rasteve vazhdojnë të trajtohen njësoj sikur bizneset. Nuk ka pasur raportime rreth pranimit të fondeve të huaja, megjithëse në vitin 2016



pjesa kryesore e burimeve të shoqërisë civile ka rrjedhë nga donacionet ndërkombëtare. Në praktikë, filantropia individuale dhe korporative nuk kanë shumë gjëra të përbashkëta. Mbi 89% të OShC've të anketuara deklaruan se nuk pranojnë fonde nga kompanitë private apo individët. Përjashtimi nga TVSH'ja aplikohet duke u bazuar më shumë në burimin e financimit se sa në statusin e OJQ'së. Vendimi Shpjegues i miratuar rishtazi krahas tjerash synon që të unifikojë procedurat e përjashtimit të TVSH'së. Megjithatë, zbatimi i duhur i këtij vendimi në praktikë mbetet për t'u vlerësuar. Është raportuar për paraqitjen e problemeve fillestare për shkak të mungesës së të kuptuarit të procedurës nga OShC'të dhe bizneset.

### **Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 1.1**

**Korniza ligjore nuk e njeh kategorinë e organizatave me bazë në komunitet. Megjithatë, ushtrimi i lirisë së asocimit pa pasur nevojë për të regjistruar një organizatë është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar gjithashtu me legjislacion primar dhe sekondar. Prandaj, kushdo mund të themelojë një organizatë, përfshirë edhe atë me bazë në komunitet) pa pasur nevojë për t'u regjistruar. Përderisa nuk ka raportime për ndonjë kufizim në funksionimin e organizatave të peregjistruara, shumica e donatorëve vendor (përfshirë institucionet shtetërore) dhe ndërkombëtarë nuk ofrojnë fonde për organizatat e peregjistruara.**

**Rregullat financiare dhe kërkesat e raportimit për OShC'të janë identike me ato të bizneseve, gjë që në përgjithësi përcjellin parimin e proporcionalitetit, mirëpo konsiderohen si të komplikuar nga disa OShC. Megjithatë, shumica e OShC've janë të pavetëdijshme ndaj legjislacionit tatimor për OShC'të. Përderisa ka shumë raste të mbështetjes pozitive të OShC've, kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës për t'u ballafaquar me specifikat që i takojnë vetëm sektorit të shoqërisë civile mbeten akoma të kufizuara. Gjatë vitit 2016 nuk është vërejtur ndonjë progres rreth kornizës ligjore dhe kapaciteteve të zbatimit, me përjashtim të Vendimit Shpjegues nga Administrata Tatimore**



që specifikon trajtimin e donacioneve në lidhje me përjashtimet nga tatimi. Shumica e dispozitave të rregullave të raportimit tatimor nuk janë përshtatur sipas qarkullimit apo përmasës së OShC'së, ndërsa është i aplikueshëm vetëm një format i raportimit. I vetmi progres parashikohet në Ligjin 04/L-057 mbi Lirinë e Asocimit në OJQ'të ku vetëm Organizatat për Përfitim Publik që kanë qarkullim vjetor mbi 100,000 Euro duhet t'i auditojnë pasqyrat e tyre financiare vjetore.

## Nën-fusha 1.2.: Liritë tjera

### Standardi 2. Liria e Tubimit Paqësor

#### Legjislacioni

Korniza ligjore për të drejtën e tubimit në Kosovë nuk i është nënshtruar ndonjë ndryshimi gjatë vitit 2016. Përfaqësuesit e OShC've Kosovare në mënyrë individuale apo përmes organizatës së tyre gëzojnë lirinë e tubimit paqësor. Është e drejtë kushtetuese sipas Nenit 43 të Kushtetutës, ndërsa Ligji 04/L-118 për Tubimet Publike u garanton të gjithë qytetarëve Kosovar të drejtën për të organizuar dhe për të marrë pjesë në tubime publike. Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë vetëm me qytetarët e Kosovës, duke e lënë të paqartë nëse të huajve u garantohet kjo e drejtë. Korniza ligjore kërkon njoftim paraprak për tubime publike, përveç nëpër ato vende ku nuk ka nevojë për masa shtesë të sigurisë. Në raste kur nuk jepet përgjigje nga ana e autoriteteve në kohën e duhur (48 orë para tubimit publik), tubimi publik mund të realizohet pa ndonjë kufizim. Nëse vërehet çfarëdo kufizimi pas njoftimit për tubim publik, organizatorët mund të apelojnë në gjykatë përmes procedurës së përshpejtuar. Kundër-tubimet nuk ndalohen shprehimisht. Megjithatë, një ndër arsyet për refuzim të lejes për tubime publike është rasti kur ndonjë tubimit tjetër publik tashmë i është dhënë leje në vendin e njëjtë apo afër me të. Kjo lë të kuptohet se kundër-tubimet nuk janë të lejueshme.



#### Praktika

Rreth 30.6% e OShC've të intervistuar deklaruan se kishin qenë të përfshirë në organizimin e protestave paqësore gjatë vitit 2016, ndërsa 12.91% të tyre raportuan të kenë hasur në disa lloj pengesash, si kufizimet që ishin të paarsyeshme dhe/ose të shpjeguara në mënyrë të paqartë apo parandalimi për të organizuar tubime publike. Për më tepër, 50.5% kishin marrë pjesë në tubime (jo domosdoshmërisht të organizuara nga ato), ku vetëm disa prej tyre kishin raportuar për disa lloje kufizimesh gjatë atyre tubimeve, kryesisht në tubimet e organizuara nga partitë politike apo ato me motive politike. Vetëm një prej OShC've të anketuara raportoi se kishte marrë pjesë në një kundër-tubim. Tubimet e OShC've, veçanërisht protestat paqësore, zakonisht organizohen nëpër sheshe publike apo para institucioneve të caktuara që janë shënjestër e protestës dhe ku

mediat kanë qasje të plotë nëpër ato tubime. Megjithëse nuk ka shifra të sakta krahasuese, viti 2016 u karakterizua me një numër të shtuar të tubimeve të organizuara nga iniciativat qytetare. Krahas tjerash, një grup i qytetarëve të pavarur të quajtur #Protestoj organizuan një sërë protestash kundër korrupsionit pas skandalit të rrjedhjes së përgjimeve telefonike, ndërsa një numër i protestave tjera u organizuan në Prishtinë dhe qytete tjera pas vdekjes së dyshimtë të një aktivisti të ri politik në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në fillim të Nëntorit të vitit 2016. Në protestat e organizuara nga OShC'të gjatë vitit 2016 ka pasur vetëm disa raste ku ishte raportuar për intervenim nga ana e policisë, siç ishte protesta e organizatave të studentëve në Kampusin e Universitetit të Prishtinës e cila u kthye në protestë të dhunshme. Në anën tjetër, përveç tubimeve të organizuara nga OShC'të, gjatë vitit 2016 disa tubime politike u shoqëruan me dhunë, si nga forcat policore ashtu edhe nga protestuesit, duke përfshirë gjithashtu edhe gazetarët në mesin e atyre që u sulmuan. Gjatë periudhës raportuese nuk pati raporte për kufizimin e qasjes së mediave në tubimet e organizuara nga shoqëria civile.

### **Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 1.2**

**Gjatë vitit 2016 nuk ka pasur ndryshime në lirinë e tubimit. Legjislacioni ekzistues dhe politikat për ushtrimin e të drejtës së tubimit paqësor janë të përcaktuara qartë. Tubimi paqësor është një e drejtë kushtetuese që gjithashtu është i rregulluar përmes legjislacionit primar. Kërkohet njoftimi paraprak dhe leje për tubimet publike, ndërsa në rast të refuzimit të lejes procedohet për apelim përmes procedurës së përsheptuar. OShC'të e ushtojnë lirisht këtë të drejtë, megjithëse jo shumë OShC deklarojnë të kenë organizuar protesta paqësore gjatë vitit 2016. Në protestat e organizuara nga OShC'të gjatë vitit 2016, ka pasur vetëm disa raste ku ishte raportuar për intervenim nga ana e policisë – me këta të fundit që ishin më të frekuentuar nëpër tubimet e organizuara nga partitë politike. Korniza ligjore mbi të drejtën e tubimit nuk ka qenë subjekt i ndryshimit në vitin 2016.**

**Përfaqësuesit e OShC've në mënyrë individuale apo përmes organizatave të tyre gëzojnë lirinë e tubimit paqësor për çështje të ndryshme të interesit të tyre. Bazuar në Nenin 40 të Kushtetutës, liria e shprehjes u garantohet të gjithëve dhe mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme për të parandaluar dhunën apo urrejtjen racore, etnike apo fetare. Nuk ka ndonjë legjislacion të caktuar primar që zbatohet në mënyrë specifike për lirinë e shprehjes. Megjithatë, një mori ligjesh përfshijnë dispozitat në lidhje me lirinë e shprehjes, siç janë Ligji Civil Kundër Shpifjes, Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligji për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, etj. Shpifja është më shumë një kundërvajtje se sa pjesë e kodit penal. Edhe pse të rralla, gjatë vitit 2016 ka pasur disa raportime të rasteve ku përfaqësues të OShC've ishin vënë nën presion apo ishin kërcënuar për fjalimin e tyre kritik kundër autoriteteve shtetërore apo për kundërshtimin e opinioneve rreth çështjeve të ndryshme, ndërsa transmetuesi publik dhe Drejtori i tyre Gjeneral ishte sulmuar. Përderisa korniza ligjore në përgjithësi është e përcaktuar qartë, ekziston mungesa e mekanizmave dhe kapaciteteve funksionale në polici dhe gjyqësi për t'i mbrojtur personat që përballen me kufizime në lirinë e tyre të shprehjes.**




## Fusha 2: Korniza për Zbatueshmëri dhe Qëndrueshmëri Financiare të OSHC'së

### Nën-fusha 2.1.: Trajtimi tatimor/fiskal për OSHC'të dhe Donatorët e tyre

#### Standardi 1: Përfitimet Tatimore


##### Legjislacioni

Korniza ligjore ofron përfitime tatimore për një sërë burimesh të të ardhurave të OShC've. Grantet, donacionet dhe subvencionet janë të përjashtuara prej tatimeve, me Vendimin Shpjegues të publikuar nga ATK që ofron shpjegime më të hollësishme rreth aktiviteteve të lartëpërmendura. Në aspektin e aktivitetit ekonomik ka paqartësi në kornizën ligjore, veçanërisht në aktivitetet ekonomike të OShC've të cilat nuk kanë status të përfitimit publik. Sipas Administratës Tatimore të Kosovës, aktivitetet ekonomike/komerciale të OPP've përjashtohen prej tatimit në të ardhurat e korporatave nëse destinacioni i të ardhurave është vetëm për qëllime të përfitimit publik dhe deri në një "nivel të arsyeshëm" të të ardhurave. Përderisa në nenin e përjashtimit tatimor përmenden vetëm OPP'të, një tjetër nen mbi aktivitetet komerciale flet për të gjitha OShC'të e regjistruara "veprimtaritë komerciale ose aktiviteti tjetër i të cilave duhet të jetë i afërm vetëm me qëllimet e tyre publike deri në një nivel të arsyeshëm të të ardhurave". Kjo nënkupton se aktiviteti ekonomik i secilës OShC të regjistruar do të lidhet drejtpërdrejtë me misionin e saj dhe të ardhurat do të duhej të ishin të arsyeshme, ndërsa të gjitha aktivitetet tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit në të ardhura. Sidoqoftë, kjo mospajtueshmëri shkakton vështirësi në interpretim dhe zbatim të saj. Nuk ka dispozita rreth ndonjë përfitimi tatimor për investimet pasive të OShC've, sikurse që nuk ka dispozita për krijimin dhe funksionimin e donacioneve e as të ndonjë përfitim tatimor të kësaj të fundit.



##### Praktika

Sikurse më parë, asnjë OShC nuk ka raportuar për ndonjë tatim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për grante apo donacione. Nuk ka të dhëna të sakta rreth numrit të OShC've që përfituan prej përjashtimit tatimor për aktivitetet e tyre ekonomike, megjithëse 16.8% të OShC've të intervistuar deklaruan se ata apo donatorët e tyre kishin qenë të përjashtuar prej disa nga tatimeve. Sidoqoftë, një analizë e detajuar e përjashtimeve të raportuara tatimore tregon se vetëm një pjesë e vogël ishte përjashtuar për shkak të statusit të tyre të OJQ'së, me përjashtim të TVSH'së (bazuar më shumë në statusin e donatorit se sa të OJQ'së) që ishte lloji më i shpeshtë i përjashtimeve tatimore. Më pak se gjysma e OShC've të anketuara (41.17%) i konsideron procedurat e përfitimit tatimor si shumë të komplikuar apo disi të komplikuar. Megjithatë, OShC'të janë mjaft të pa informuara për legjislacionin tatimor – studimet e mëhershme tregojnë se pothuajse gjysma e OShC've nuk janë në dijeni të këtyre procedurave.





Meqenëse nuk mund të vëreheshin praktikatat e krijimit apo funksionimit të një donacioni në Kosovë, nuk ishte raportuar për ndonjë përfitim tatimor për donacione. E njëjta gjë vlenë gjithashtu edhe për investimet pasive.

### Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 2.1

Nuk ka pasur ndryshime në legjislacion sa i përket Ligjit për Tatim në të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjit për Tatim në të Ardhurat Personale. Grantet, donacionet dhe subvencionet janë të përjashtuara nga tatimet. Vendimi Shpjegues i publikuar nga Administrata Tatimore e Kosovës në Gusht të vitit 2016 qartëson përjashtimin e lartpërmendur si dhe paraqet një procedurë unike të përjashtimeve nga TVSH për shpenzime të financuara nga donatorët e huaj. Nuk ka të dhëna zyrtare rreth numrit të taksapaguesve të regjistruar individual dhe korporativ të cilët dhuruan donacione për OShC'të. Nga ana tjetër, vetëm një pjesë e vogël e OShC've deklaruan të kenë fituar donacione nga donatorët privat vendor gjatë vitit 2016, ndërsa numri i raportimeve që donatorët e tyre kanë pranuar ndonjë përfitim tatimor është edhe më i vogël. Kjo nënkupton se edhe në ato raste të kufizuara kur korporatat private ose individët vendosin t'i dhurojnë OShC've donacione, stimulimet tatimore nuk janë arsyeja pse ata ndërmarrin këtë veprim.


Në përgjithësi, shumë pak OShC angazhohen në aktivitete ekonomike. Ka paqartësi në kornizën ligjore për përfitimet tatimore për aktivitetet ekonomike të OShC've, veçanërisht për ato të cilat nuk kanë status të përfitimit publik. Interpretimi kryesor është se aktivitetet ekonomike/komerciale të Organizatave për Përfitim Publik përjashtohen prej tatimit në të ardhurat e korporatave nëse destinacioni i të ardhurave është vetëm për qëllime të përfitimit publik dhe deri në një "nivel të arsyeshëm" të të ardhurave. Përderisa neni në lidhje me përjashtimin tatimor përmendë vetëm OPP'të, një tjetër nen mbi aktivitetet komerciale i referohet të gjitha OShC've të regjistruara "veprimtaritë komerciale ose aktiviteti tjetër i të cilave duhet të jetë i afërm vetëm me qëllimet e tyre publike deri në një nivel të arsyeshëm të të ardhurave". Kjo nënkupton se aktiviteti ekonomik i secilës OShC të regjistruar do të lidhet drejtpërdrejtë me misionin e saj dhe të ardhurat do të duhej të ishin të arsyeshme, ndërsa të gjitha aktivitetet tjera ekonomike i nënshtrohen tatimit në të ardhura. Sidoqoftë, kjo mospajtueshmëri shkakton vështirësi në interpretim dhe zbatim të saj.

### Nën-fusha 2.2.: Mbështetja Institucionale

#### *Standardi 1. Disponueshmëria e Financimit Publik*

#### Legjislacioni

Pas propozimit nga Këshilli për zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017, në Maj të vitit 2016 Qeveria miratoi modelin për financim publik të OShC've. Ky model nënkupton se përgjegjësia kryesore për shpërndarjen e fondeve publike të OShC've bie mbi ministritë dhe komunat përkatëse në përputhje me dokumentet strategjike relevante dhe prioritetet e



tyre. Shpërndarja e decentralizuar do të kryhet në përputhje me parimet dhe procedurat e unifikuar, ndërsa një njësi qendrore do të monitorojë nëse këto parime dhe procedura janë duke u respektuar. Që nga Shtatori i vitit 2016 është krijuar një grup punues i cili punon në hartimin e Rregullores për financim publik të OShC've. OShC'të e përfshira në organet e zbatimit të Strategjisë kanë marrë pjesë në diskutim dhe hartim të modelit si dhe të rregullores.

Ndërkohë, nuk ekziston ndonjë ligj i veçantë apo politikë shtetërore që rregullon mbështetjen institucionale për OShC'të, sikurse që nuk ekzistojnë mekanizmat e nivelit kombëtar apo lokal për shpërndarjen e fondeve publike për OShC'të. Fondet ekzistuese të OShC've shpërndahen prej institucioneve të caktuara në nivel qendror dhe lokal pa ndonjë bashkëpunim apo arsyetim dhe pa u planifikuar brenda buxhetit të shtetit. Nuk ka ndonjë politikë apo mekanizëm shtetëror të financimit publik për zhvillim institucional të OShC've dhe bashkë-financim me grantet e BE'së dhe grantet tjera. Duke pasur parasysh se cikli standard buxhetor mbulon vetëm një (1) vit, është vështirë që të financohet ndonjë program apo grant për zhvillim institucional brenda një periudhe kaq të shkurtër kohore, ndërkohë që nuk janë vërejtur raste të financimit më të gjatë kohor. Ndonëse Strategjia Shtetërore për bashkëpunim me shoqërinë civile kërkon përgatitjen e një skeme të bashkë-financimit për fondet e BE'së për shoqërinë civile, gjatë vitit 2016 nuk është ndërmarrë ndonjë iniciativë në lidhje me këtë. Ligji 04/L-80 për lojërat e fatit ofron mundësinë për të menaxhuar një shumë të caktuar të fondeve nga Lotaria e Kosovës për kategori të ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport. Detajet e një transferi të tillë duhet të përcaktohen përmes një udhëzimi administrativ, mirëpo një udhëzim i tillë ende nuk është hartuar. Nuk ka procedura apo kërkesa të caktuara për ndonjë pjesëmarrje të OShC've në ciklin e financimit publik.

## Praktika

Ekzistojnë shumë pak raste të financimit publik për zhvillimin institucional të OSHC've dhe bashkë-financimin e granteve të BE'së dhe granteve tjera, ndërkohë që mbështetja e projektit

Pavarësisht nga të qenit një hap shumë pozitiv drejt transparencës së financimit publik për OJQ'të, raporti i Qeverisë për financim publik të OJQ've ka mangësira serioze dhe nuk ofron një gjendje të saktë të situatës në këtë fushë. Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së sistemit të duhur për shfrytëzimin e të dhënave. Një analizë detajore e këtij raporti të zhvilluar nga KCSF nxjerr në pah në mënyrë të konsiderueshme të dhëna të ndryshme, veçanërisht në lidhje me shumën e përgjithshme. Kur federatat dhe klubet sportive ishin mënjanuar nga lista e publikuar, shumën e financimit të OJQ've ishte zvogëluar për rreth 7 milion Euro për dy vite. Pas zvogëlimit të mëtejshëm të shumës me vlerë prej më pak se 1 milion Euro të shpërndara tek institucionet publike që në raport u listuan si OJQ si dhe shumën që u vlerësuan si pagesa të shërbimeve apo fonde tjera të donatorëve që u kanalizuan përmes institucioneve publike (rreth 9 milion Euro për dy vite), shumën përfundimtare që do të mund t'i dhurohej OJQ've për dy vite është pak më shumë se 10 milion Euro. Për më tepër, pas përmirësimit të emrave të OJQ've të listuara në raport dhe mënjanimit të OJQ've që u numëruan disa herë, numri i OJQ've përfutuese nuk e tejkalon shifrën e 1800 për dy vite. E fundit por shumë e rëndësishme, analiza detajore e raportit të KCSF'së nxjerr në pah që rreth 90% të pagesave për OJQ'të janë nën 10,000 Euro, me vetëm 4.4% prej tyre që e tejkalojnë shumën prej 25,000 Euro.

është e pranishme në shumicën e rasteve si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror. Me raportin e parë për financim publik për OJQ'të të publikuar nga Qeveria u nxorrën në pah disa informata rreth financimit publik. Para se gjithash raporti vërtetoi shqetësimet e ngritura nga shoqëria civile që të dhënat rreth financimit publik të OJQ've nuk shfrytëzohen siç duhet brenda administratës shtetërore. Kjo rezultoi me informacion shumë të kufizuar në dispozicion për raportin si dhe me raste të shumta të kategorizimit joadekuat brenda raportit. Kishte raste ku për shkak të pakujdesisë apo gabimeve teknike, një OJQ ishte numëruar më shumë se një herë si

përfutues e granteve. Poashtu është vërejtur, mungesë e diferencimit midis pagesës së

shërbimeve dhe granteve për OJQ'të, mungesë e informacioni mbi karakterin e projekteve/programeve të mbështetura etj. Sipas raportit të qeverisë, shuma e përgjithshme e fondeve të transferuara prej buxhetit shtetëror tek OJQ'të gjatë vitit 2016 ishte 13,883,316.78 EUR, me shuma shumë të ngjashme të raportuara edhe për vitin 2015. Përderisa komunat kanë pasur një pjesë më të madhe për të dyja vitet, niveli qendror ishte karakterizuar me një rritje të lehtë gjatë vitit 2016, ndërsa e kundërta vlenë për nivelin lokal. Numri i përfituesëve të OJQ've për vitin 2016 ishte raportuar të jetë 1,659, ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ishte institucioni i cili u shpërndau më së shumti fonde OJQ've.


Bazuar në të dhënat nga anketa, 52.48% e OJQ've të anketuara kanë raportuar të kenë aplikuar për financim publik gjatë vitit 2016, që është pak më shumë se gjysma e tyre që pranojnë fonde të tilla (34.65% e të gjitha OShC've të anketuara). Në buxhetin e vitit 2016 ishin identifikuar vetëm dy raste të planifikimit të caktuar për përkrahje të projektit të OShC'së në nivel qendror/lokal. Sipas buxhetit të vitit 2016, buxheti i komunës së Rahovecit përfshiu 10,000 EUR për OJQ'të me çështje sociale; në komunën e Istogut një linjë buxhetore prej 15,000 EUR iu dedikua pjesëmarrjes në projektin kryesor përmes OJQ've, komunitetit dhe donatorëve tjerë. Gjashtë komunat tjera kanë linja të caktuara buxhetore që i dedikohen çështjeve të barazisë gjinore, mbështetjes për rininë apo shërbimeve kulturore. Pavarësisht mundësive ligjore, gjatë vitit 2016 nuk është mbledhur apo shpërndarë asnjë fond nga lotaria. Meqenëse buxhetimi me pjesëmarrje nuk është i zakonshëm në Kosovë, OShC'të nuk janë pjesë e ndonjë faze të ciklit të financimit publik, madje as të financimit publik për shoqërinë civile.

## Standardi 2. Shpërndarja e Financimit Publik

### Legjislacioni


Ndonëse Rregullorja për financim publik të OJQ've është në procesin e hartimit, në vitin 2016 nuk ishin bërë ndryshime në procedurat për shpërndarjen e fondeve publike. Nuk ka procedura specifike për shpërndarjen e fondeve publike tek OShC'të, duke përfshirë mungesën e kriterëve standarde të përzgjedhjes që do të garantonin që financimi publik të shpërndahej në mënyrë të përcaktuar. Një numër i ministrive kanë legjislacion specifik sekondar për "shpërndarjen e subvencioneve për OJQ'të",

mirëpo baza ligjore e këtyre rregulloreve mbetet e paqartë. Për më tepër, këto rregullore nuk përfshijnë gjithë ciklin e financimit publik dhe çështjet e njejta i trajtojnë në mënyrë dhe nivele të ndryshme të detajeve, varësisht nga ministria e caktuar. Procedurat e vetme specifike të OShC'së për trajtimin e konfliktit të interesit janë të lidhura me OShC'të dhe me zyrtarët publik si anëtarë të Bordit përballë financimit shtetëror në kuadër të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.



### Praktika

Për shkak të mungesës së planifikimit të caktuar buxhetor dhe informacionit rreth përzgjedhjes, është shumë e vështirë që të grumbullohet informacioni i duhur rreth llojit të projekteve dhe organizatave që përfitojnë prej fondeve publike. Informacioni në lidhje me procedurat e financimit



dhe informacioni rreth projekteve të financuara është shumë rrallë i disponueshëm publikisht, ku Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Integritimit European dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë ndër institucionet e pakëta që publikojnë disa të dhëna. Organet shtetërore nuk zotërojnë e as nuk zbatojnë procedurat e harmonizuara. Rreth 71% të OShC've të anketuara pajtohen ose pjesërisht pajtohen që kërkesat për aplikim nuk janë të ekzagjeruara dhe se të gjitha format e aplikimit janë të kuptueshme. Ndërkaq, vetëm një pjesë e OShC've të anketuara konsiderojnë se vendimet rreth tenderëve janë të paanshme, që ata shpallen publikisht dhe nuk përbëjnë konflikt interesi.

### Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 2.2


Pas miratimit të një modeli të përgjithshëm të financimit publik për OJQ'të, Qeveria ka filluar hartimin e një rregulloreje të caktuar për këtë çështje. Modeli dhe draft-rregullorja sugjerojnë për një sërë parimesh dhe procedurash të unifikuara të financimit publik për OShC'të që do të përcaktohen dhe monitorohen nga një autoritet qendror, ndërsa do të zbatohen nga secila ministri përkatëse në përputhje me specifikimet e saja. Ndërkohë, në Kosovë nuk ekziston ndonjë kornizë institucionale për financim të OShC've, megjithëse institucionet shtetërore rregullisht u ofrojnë fonde OShC've. Të dhënat e duhura rreth financimit publik të OJQ've nuk janë në dispozicion për shkak se nuk ekziston përfshirja e përfituesve në përcaktimin e tenderëve dhe kriterëve të qarta të publikuara paraprakisht, afateve kohore për vendimmarrje dhe vendimeve meritorë me argumente. Raporti i parë qeveritar për financim publik për periudhën 2015-2016 nxorri në pah disa të dhëna rreth shumës së fondeve të shpërndara në sektorin e shoqërisë civile, megjithëse raporti nuk është plotësisht i besueshëm për shkak të mungesës së shfrytëzimit të duhur të të dhënave nga institucionet publike.

## Nën-fusha 2.3.: Burimet Njerëzore

### Standardi 1. Punësimi nëpër OSHC

#### Legjislacioni

Legjislacioni aktual i punës nuk përfshin dispozita të caktuara për OShC'të, pasi që ato përmbajnë kërkesa të njejta me ato të punëdhënësve. Mëgjithatë, dispozitat e pushimit të lehonisë, kontributeve pensionale dhe sigurimet shëndetësore publike të cilat janë obligative për të gjithë punëdhënësit janë problematike për OShC'të. Për shkak të mbizotërimit të financimit të projekteve në sektorin e shoqërisë civile, vetëm disa prej OShC've kanë fonde të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e tyre të pagesës së këtyre obligimeve. Një tjetër sfidë e identifikuar nga OShC'të në lidhje me legjislacionin e punës janë kontratat e bazuara në projekte për personelin e tyre të cilat jo domosdoshmërisht mbulojnë të gjitha përfitimet e mundshme për të punësuarit e që garantohet me Ligjin e Punës, posaçërisht ato që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e punësimit.



#### Praktika


OSHC'të nuk trajtohen në programet shtetërore të nxitjes së punësimit dhe në përgjithësi sektori i shoqërisë civile nuk trajtohet si një nga sektorët që kontribuojnë në punësim. Përderisa ekzistojnë programe të caktuara për krijimin e vendeve të punës përmes sektorit publik dhe privat, OShC'të nuk janë pjesë e ndonjë mbështetjeje apo stimulimi. Vetëm dy prej OShC've të anketuara kanë deklaruar të kenë përfituar nga programet shtetërore për mbështetjen e punësimit gjatë vitit 2016. Ka shumë pak statistika të besueshme rreth numrit të të punësuarëve në sektorin e OJQ've në Kosovë. Sipas të dhënave nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), me rreth 312,672 të kontributdhënësve të përgjithshëm aktiv gjatë vitit 2016 OJQ'të morrën pjesë me 11,997 kontributdhënës aktiv, përkatësisht 3.83% të numrit të gjithëmbarshtëm të kontributdhënësve pensional aktiv në Kosovë. Mëgjithatë, vetëm 3,486 kontributdhënës aktiv kanë paguar kontributet pensionale për plotë dymbëdhjetë muajt e vitit 2016. Me një shpërndarje të përgjithshme gjinore të kontributdhënësve pensional që është dukshëm në favor të meshkujve (68.2% deri në 31.8%), OJQ'të janë pothuajse të balancuara, me 53.1% në favor të meshkujve. Nga ana tjetër, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka statistika tepër të kufizuara që kanë të bëjnë me shoqërinë civile.

## Standardi 2. Puna vullnetare tek OSHC'të

### Legjislacioni

Nuk është bërë ndonjë ndryshim në kornizën ligjore për punën vullnetare gjatë vitit 2016, pavarësisht disa takimeve të mbajtura në kuadër të Objektivit 4 të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. Këto takime nuk çuan në rezultate konkrete të legjislacioni apo programeve specifike për punë vullnetare.

I vetmi ligj i cili përfshin dispozita mbi punën vullnetare mbetet Ligji 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë i cili synon që të nxisë vullnetarizmin e të rinjve. Kategoritë tjera të vullnetarizmit nuk trajtohen nga ndonjë ligj apo rregullore. Regjistrimi i vullnetarëve të rinj është i detyrueshëm ashtu sikurse që janë detyrimet për marrëdhënie kontraktuale dhe mbrojtje për vullnetarizimin e organizuar të të rinjve. Sidoqoftë, procedurat administrative për organizatorët nikoqir të vullnetarëve të rinj janë të komplikuar dhe problematike për OShC'të. Përfundimisht, më pak se një e treta e OShC've të anketuara e perceptojnë mjedisin politik dhe ligjor për vullnetarizëm si të favorshëm.



### Praktika

Gjatë vitit 2016, nuk janë identifikuar programe të vullnetarizimit nga ana e institucioneve shtetërore. 79.2% të OShC've të anketuara deklaruan të kenë angazhuar vullnetarë gjatë vitit 2016, ku gjysma prej tyre deklaruan të kenë 10 apo më shumë vullnetarë. Megjithatë, pak prej tyre nënshkruajnë marrëveshje/kontrata me vullnetarët. Sistemi i regjistrimit për vullnetarët e rinj i cili parashikohet me Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë nuk ka funksionuar gjatë vitit 2016, me përjashtim të disa komunave të cilat kanë deklaruar se zotërojnë sistem funksional të regjistrimit të vullnetarëve të rinj. Në përgjithësi, vullnetarizmi realizohet në shumë forma dhe lloje të OShC've, kryesisht pa ndonjë procedurë formale. Të dhënat e fundit në dispozicion rreth vullnetarizmit janë ato të vitit 2015, të cilat tregojnë se vetëm 3.8% të qytetarëve Kosovar punuan vullnetarisht për organizatat e shoqërisë civile gjatë atij viti.<sup>14</sup>

### **Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 2.3**

**Bazuar në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, numri i kontributdhënësve pensional prej sektorit të OShC've në vitin 2016 ishte 11,977, prej të cilëve 3,486 punojnë në sektor për dymbëdhjetë muaj të plotë të vitit 2015. Këto statistika ofrohen në bazë të kërkesës, ndërsa akoma nuk mund të konsiderohen si plotësisht të sakta, pasi që nuk ekzistojnë detaje të informatave nëse punonjësit e OShC've punojnë me orar të plotë, me orar të shkurtuar apo në baza ditore. Sipas të dhënave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, gjatë vitit 2016 sektori i OJQ've kishte 3.83% të numrit të gjithëmbarshtëm të kontributdhënësve pensional aktiv në Kosovë. OShC'të trajtohen në mënyrë të barabartë me sektorët tjerë përbrenda Ligjit të Punës, pavarësisht nga vështirësitë për të zbatuar një sërë dispozitash (do të thotë pushimi i lehonisë me pagesë), ndërsa sektori i shoqërisë civile nuk është pjesë e politikave dhe programeve të cilat promovojnë punësimin.**

**Numri i vullnetarëve të OShC've nuk është në dispozicion, sikurse numri i orëve të punës vullnetare nëpër OShC. Si rrjedhojë, është e pamundur që të ketë vlerësim të saktë**

<sup>14</sup> Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, KCSF 2016



nëse puna vullnetare është duke u shtuar apo duke u zbehur. Të dhënat e fundit në dispozicion rreth punës vullnetare janë ato të vitit 2015, të cilat tregojnë se vetëm 3.8% të qytetarëve Kosovar kanë punuar si vullnetar për shoqërinë civile gjatë atij viti. Përveç një numri të dispozitave mbi punën vullnetare të të rinjve, nuk ekziston ndonjë kornizë ligjore për të rregulluar dhe promovuar punën vullnetare në shoqërinë civile. Gjithashtu, nuk ka dispozita ligjore të cilat mundësojnë rimbursimin nga lirimi i tatimit prej shpenzimeve të udhëtimit dhe atyre ditore për vullnetarët. Si rezultat, puna vullnetare në shumicën e rasteve realizohet në një mënyrë joformale.


### Fusha 3: Marrëdhënia Qeveri-OSHC

#### Nën-fusha 3.1.: Korniza dhe Praktikrat për Bashkëpunim

*Standardi 2. Institucionet dhe Mekanizmat për Zhvillim të Shoqërisë Civile dhe për bashkëpunim me shoqërinë civile Bashkëpunimit me to*


##### Legjislacioni

Këshilli për zbatimin e Strategjisë, si një organ i përbashkët dhe i autorizuar për të monitoruar dhe raportuar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, vazhdoi punën e tij gjatë vitit 2016. Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyres së Kryeministrit (ZQM/ZK) vazhdon të jetë njësi kryesore e bashkëpunimit qeveritar me shoqërinë civile e cila shërben si Sekretariat i Këshillit. Rregullat e Procedurave të Këshillit garantojnë se të gjitha iniciativat që rrjedhin prej OShC've merren në konsideratë dhe të njëjtat zbatohen edhe për Grupet Punuese të Këshillit. Sa i përket Kuvendit, gjatë vitit 2016 nuk janë raportuar për ndryshime në përbërjen institucionale të saj për bashkëpunim me shoqërinë civile.



##### Praktika

Me një numër të vogël të personelit, krahas detyrave tjera, në kordinim dhe zbatim të Strategjisë dhe pa ndonjë buxhet të caktuar për zbatim të tij, ZQM/ZK mbetet me burime të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për të lehtësuar dialogun në mes të shoqërisë civile dhe Qeverisë në të njëjtën mënyrë sikurse shërben si një sekretariat për Këshillin. Një projekt i Asistencës Teknike i



financuar nga BE që i dedikohet zbatimit të Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile filloi në pranverën e vitit 2016 dhe ka ofruar pjesën kryesore të ekspertizës dhe financimit në interes të Qeverisë për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2016. Këshilli për zbatim të Strategjisë ishte takuar tri herë, ndërsa Grupet Punuese për secilin prej 4 Objektivave

Strategjike kanë mbajtur takime më të shpeshta. Përderisa anëtarët e OShC've në Këshill janë të përfshirë rregullisht në punën e Këshillit dhe Grupeve Punuese e njehta gjë nuk mund të thuhet për një pjesë të madhe të sektorit të shoqërisë civile – vetëm 30.29% e OShC've të anketuara deklaruan të kenë komunikuar me ZQM/ZK gjatë vitit 2016. Një pjesë e vogël e OShC've (21%) deklaruan të kenë komunikuar me Zyrtarin e Kuvendit për bashkëpunim me shoqërinë civile.

### Konkluzionet e Matricës së Monitorimit 3.1

Strukturat dhe mekanizmat për dialog dhe bashkëpunim në mes të OShC've dhe institucioneve publike kanë vazhduar punën e tyre gjatë vitit 2016, me një progres të vogël në fushën e konsultimeve publike dhe financimit publik për OJQ'të. Këto ishin dy Objektivat Strategjike të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 që janë karakterizuar me një nivel solid të zbatimit, ndërsa dy objektivat tjerë mbeten prapa në zbatim. Nga ana tjetër, përkundër zotimit për caktimin e buxhetit për zbatimin e Strategjisë, në kohën kur ky dokument ishte miratuar nuk ishin caktuar mjetet financiare për ndonjë njësi qeveritare përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve, ndërsa shumica e aktiviteteve ishin zhvilluar përmes mbështetjes së donatorëve. Me pjesën kryesore të ekspertizës që vjen në mbështetje të kësaj Strategjie, ose prej shoqërisë civile ose prej projektit të asistencës teknike të financuar nga BE, mungesa e inputeve cilësore dhe me kohë nga ministritë përkatëse mbetet një shqetësim. Në aspektin e institucioneve, Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit mbetet organi përgjegjës i Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Asnjë ministri apo institucion tjetër qendror, përveç Këshillit Prokurorial të Kosovës, nuk ka caktuar pikat e kontaktit për shoqërinë civile. Kjo



vlenë edhe për nivelin lokal ku vetëm Komuna e Mitrovicës së Jugut ka një pikë të kontaktit të caktuar për shoqërinë civile.

Zyrtari për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe donatorët mbeten përgjegjës për komunikimin e Kuvendit me shoqërinë civile. Gjatë vitit 2016, kjo zyre ka organizuar disa aktivitete në mbështetje të përfshirjes së shoqërisë civile në punën e Kuvendit. Deklarata për partneritet midis Kuvendit të Kosovës dhe shoqërisë civile që ishte miratuar në vitin 2015 deri më tani nuk ka shënuar rezultate të dukshme.

Në përgjithësi, përfshirja e institucioneve përgjegjëse për bashkëpunim me shoqërinë civile si në nivel të qeverisë ashtu edhe në atë të Kuvendit është e kufizuar dhe një pjesë e konsiderueshme e OShC've nuk kanë ndonjë komunikim apo bashkëpunim me këto institucione.


### Nën-fusha 3.2.: Përfshirja në Procesin e Politikëbërjes dhe Vendim-marrjes

#### Standardi 1. Standardet për Përfshirjen e OSHC've

##### Legjislacioni

Progresi kryesor në lidhje me konsultimet publike ishte miratimi i Rregullores për Standardet Minimale për konsultimin publik në Prill të vitit 2016, bazuar në një propozim nga ana e shoqërisë civile. Grupi i standardeve paraqet një bazë sistematike për konsultim publik duke filluar prej caktimit të agjendës dhe përfshirjen e ekspertëve e deri tek konsultimet e përgjithshme publike me kërkesa të caktuara për secilin veprim. Për më tepër, është projektuar një platformë online për të shërbyer si një pikënisje për të gjitha palët e interesuara që të përfshihen në procesin e konsultimit. Përderisa monitorimi i zbatimit të këtyre standardeve do të bazohet në sistemin

ekzistues të monitorimit të ciklit të politikave dhe ligjit, raportet vjetore rreth detajeve të procesit të konsultimit publik kërkohen si prej ministrive përkatëse ashtu edhe prej Zyrës së Kryeministrit. Kjo rregullore bazohet në kërkesat e përgjithshme ekzistuese të përcaktuara nga Rregullorja e Punës së Qeverisë, e cila kërkon konsultime publike për të gjitha draft-politikat/projekt-ligjet me informacione adekuate të ofruara me kohë që duhet të sigurohen nga ana e autoritetit propozues si dhe prapaveprimin rreth rezultateve të konsultimit. Rregullorja hyn në fuqi që nga 1 Janari i vitit 2017. Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk është ndryshuar dhe ajo ofron mundësi, jo obligative, për të ftuar OShC'të dhe për të organizuar dëgjime publike. Ligji për Vetëqeverisje Lokale ofron instrumente të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në nivel lokal, duke përfshirë konsultimet publike, komitetet sektoriale të konsultimeve, petitionet, takimet publike me Kryetarin e Komunës, etj. Legjislacioni sekondar përcakton një mori detyrimesh të cilat do të garantonin publikimin e dokumenteve komunale dhe përfshirjen publike në vendim-marrje. Megjithatë, këto dispozita janë shumë të paqarta dhe i lënë një hapësirë të madhe interpretimeve të ndryshme. Për të sqaruar, kërkohet që "vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë në interesin e qytetarëve të publikohen në faqen e internetit të Komunës", mirëpo nuk ekzistojnë kritere apo udhëzime që do të përcaktonin se cilat vendime përfshihen në kategorinë përkatëse. Sa i përket kapaciteteve të nëpunësve civil për t'u përfshirë në shoqërinë civile, gjatë vitit 2016 është hartuar dhe ofruar një modul i trajnimeve për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik. Përderisa seancat



e trajnimit u organizuan nga projekti i AT të financuar nga BE në mbështetje të Strategjisë, Instituti Kosovar për Administrim Publik nuk ka përfshirë modulet që mbulojnë këtë temë në kurrikulën e vet zyrtare, pavarësisht se është i detyrueshëm ta bëjë këtë sipas Strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Së fundi, sipas kërkesave të Rregullores mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik, ministrive u kërkohet që të caktojnë një Koordinator për procesin e konsultimit publik i cili do të jetë përgjegjës për t'u ofruar këshillime nëpunësve tjerë civil dhe për të përgatitur raporte vjetore në lidhje me këtë proces.

## Praktika

Pavarësisht nga kërkesat afirmative ligjore, OShC'të nuk ftohen në mënyrë rregullt për të komentuar rreth propozimeve të politikave/ligjeve. Në vitin 2016 vetëm 24.75% të OShC've të anketuara janë ftuar rregullisht për të komentuar rreth propozimeve të politikave/ligjeve në fushat e tyre të interesit, ndërsa pak më shumë se gjysma e tyre deklaruan se kishin pasur kohë të mjaftueshme për të komentuar rreth propozimeve. Kryesisht ftesat dërgohen me anë të njoftimeve publike të draft-propozimeve përmes Platformës CiviKos, nganjëherë duke i publikuar draftet në faqet e internetit të Ministrive dhe shumë rrallë në kanalet tjera. Publiku nuk konsultohet në fazën e hershme të një propozimi e kjo vërtetohet nga rezultatet e anketës, ku më pak se një e treta e OShC've të anketuara mendojnë se për projekt-ligjet dhe draft-politikat konsultohet që nga faza fillestare. Prej 53 projekt-ligjeve të miratuara nga Qeveria gjatë vitit 2016 vetëm 27 prej tyre u njoftuan publikisht për konsultim publik përmes Platformës CiviKos. Edhe më keq qëndron proporcioni i dokumenteve të miratuara dhe të konsultuara kur bëhet fjalë për Koncept Dokumentet (26/7), Dokumentet Strategjike (8/2) dhe Udhëzimet Administrative (61/23).<sup>15</sup> Përderisa njoftimi rreth rezultateve të konsultimeve publike ofrohet rrallë herë, më shumë se gjysma e OShC've që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik vlerësojnë se komentet e tyre janë pranuar në tërësi (9.52%) ose janë pranuar pjesërisht (47.62%). Në nivel lokal, shumica e komunave në punën e tyre zakonisht nuk e përfshijnë shoqërinë civile, ndërsa nuk është funksional një numër i madh i instrumenteve ligjore për pjesëmarrje. Në nivel të Kuvendit, vetëm një pjesë e ligjeve në fuqi u nënshtohen dëgjimeve publike, ndërsa llojet tjera të konsultimit publik nuk janë të rëndomta. Sipas OShC've që punojnë me Kuvendin e Kosovës, shembujt më pozitiv të dëgjimeve publike janë ato të bashkë-organizuar nga OShC'të apo organizatat ndërkombëtare. Kuvendi ka një databazë funksionale të të dhënave për OJQ've e interesuara në punën e këtij institucioni i cili shërben edhe si platformë për ftesën e OJQ've në takimet e komisioneve dhe në dëgjime publike. Megjithatë, është një praktikë mjaft e zakonshme që ftesat të dërgohen në mënyrë automatike vetëm në mbrëmje para takimit. Gjatë vitit 2016 Zyra për Qeverisje të Mirë përmes projektit të AT të financuar nga BE në mbështetje të Strategjisë ka trajnuar rreth 100 nëpunës civil në dy runde të trajnimeve mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimeve publike. Koordinatorët për procesin e Konsultimit Publik të caktuar prej disa ministrive kanë përfunduar një seancë të trajnimit mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik.


### *Standardi 3. Përfaqësimi i OSHC've në Organet Ndër-Sektoriale*

## Legjislacioni


---

<sup>15</sup> Raporti monitorues për konsultimin publik me organizatat anëtare të Platformës CiviKos për vitin 2016, Platforma CiviKos 2017

Nuk është bërë ndonjë ndryshim në legjislacionin për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në organet vendim-marrëse apo këshillimore të themeluara nga institucionet publike. Legjislacioni në nivel qeveritar lejon por nuk e detyron qeverinë që të ftojë përfaqësuesit e OShC've për të marrë pjesë në këto organe. Si përjashtim, komitetet sektoriale të konsultimeve në nivel komunal do të duhej të krijoheshin dhe përbëheshin prej qytetarëve dhe shoqëria civile, mirëpo vetëm një numër i vogël i komunave e kanë përmbushur këtë obligim. Një numër i organeve të pavarura ose këshillimore kanë rregulla të veçanta procedurale të cilat parashikojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesëve të shoqërisë civile, përfshirë procedurat e përzgjedhjes. Përveç këtyre rasteve të veçanta, nuk ekzistojnë udhëzime apo mekanizma të standardizuar të përzgjedhjes të cilat do të siguronin përfaqësim të duhur nga shoqëria civile.



Praktika



Një sërë organesh ekzistuese, të tilla si Këshilli Kombëtar për Integrim Europian, Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit apo Këshilli për zbatimin e Strategjisë vazhduan që në punën e tyre të përfshijnë përfaqësuesit e shoqërisë civile. Sidoqoftë, ka pasur probleme në përfaqësimin e shoqërisë civile dhe atë në rastin e parë kur Presidenti i ri, pa ndonjë arsytim, ftoi vetëm disa prej anëtarëve të OShC've të Këshillit Kombëtar për Integrim Europian. Kjo shkaktoi pakënaqësi dhe detyroi edhe personat e ftuar që

ta bojkotojnë mbledhjen. Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar disa raste të proceseve të hapura të përzgjedhjes, kryesisht të fasilituara nga Platforma Civikos. Me rreth gjysmën e OShC've të anketuara që kanë marrë pjesë në disa forma të organeve ndër-sektoriale, vetëm 11.88% deklaruan të jenë përzgjedhur përmes një procedure të hapur dhe transparente. Në përgjithësi, në kuadër të këtyre organeve, përfaqësuesëve të OShC've u lejohet që të paraqesin dhe mbrojnë qëndrimet e tyre pa u sanksionuar. Në mënyrë të ngjashme, shumica e OShC've që marrin pjesë në organet vendim-marrëse dhe këshillimore aplikojnë për mënyra alternative të avokimit të cilat jo domosdoshmërisht janë në harmoni me qëndrimet e organit përkatës. Që të dy nga të lartpërmendurat tani përfshihen qartë në Rregulloren mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik.

Ekzistojnë kërkesat ligjore për konsultim me OShC'të në nivel qeveritar. Megjithatë, mundësitë ligjore nuk shfrytëzohen siç duhet kryesisht për shkak të zbatimit të dobët nga ana e autoriteteve publike. Përderisa qasja në informacion është përmirësuar gjatë dy viteve të fundit, më pak se 1/3 e OShC've deklaruan të jenë ftuar rregullisht për të komentuar rreth propozimeve të politikave/ligjeve në fushat e tyre të interesit gjatë vitit 2016. Ndonëse njoftimi rreth rezultateve të konsultimeve publike jo rëndom ofrohet ose bëhet publik, pothuajse gjysma e atyre OShC've që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik vlerësojnë se komentet e tyre janë pranuar pjesërisht. Nuk ekzistojnë mekanizma standarde të përzgjedhjes, ndërsa vetëm disa organe kanë përzgjedhur përfaqësuesit e OShC've përmes procesit të hapur, transparent dhe demokratik. Meqenëse në këtë fushë nuk ekziston ndonjë monitorim dhe raportim sistematik, në dispozicion nuk ka të dhëna të sakta rreth përqindjes së ligjeve/akteve nënligjore, strategjive dhe reformave politike të cilat janë konsultuar në mënyrë efektive me OShC'të. E arritura kryesor gjatë vitit 2016 ka qenë Rregullorja mbi Standardet Minimale për procesin e Konsultimeve Publike e miratuar nga Qeveria në Prill të vitit 2016 që hyn në fuqi me 1 Janar të vitit 2017.

Në nivel lokal, shumica e komunave në punën e tyre zakonisht nuk përfshijnë shoqërinë civile, ndërsa nuk është funksional një numër i madh i instrumenteve ligjore për pjesëmarrje.

Në nivel të Kuvendit, dispozitat ligjore mbi konsultimin me OShC'të nuk kanë karakter obligativ. Vetëm një pjesë e ligjeve në fuqi u nënshtrohen dëgjimeve publike, ndërsa nuk janë të zakonshme llojet tjera të konsultimeve publike. Sipas monitorimit të punës së Kuvendit nga ana e OShC've, shembujt më pozitiv të dëgjimeve publike janë ato që bashkë-organizohen me OShC'të apo organizatat ndërkombëtare.


### Nën-fusha 3.3.: Bashkëpunimi në Ofrimin e Shërbimeve

*Standardi 1. Angazhimi i OShC've në Ofrimin e Shërbimeve dhe Konkurrenca për Kontratat*

*Shtetërore*

#### Legjislacioni

Nuk ka pasur ndryshime në kornizën ligjore për ofrimin e shërbimeve nga OShC'të gjatë vitit 2016. Legjislacioni ekzistues u lejon OShC've që të ofrojnë shërbime në fusha të ndryshme. Kërkesat ligjore janë të barabarta për të gjitha subjektet ligjore, duke përfshirë OShC'të dhe nuk ka kërkesa shtesë për OShC'të nëse ato dëshirojnë të angazhohen në kontrata shtetërore. Dispozitat më specifike janë të pranishme në shërbimet sociale të cilat rregullohen me Ligjin 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare (dhe amendamentimet e tij) i cili zyrtarisht pranon mundësinë dhe lejon që shërbimet e ndryshme sociale të ofrohen nga OShC'të. Në përgjithësi, ky ligj e merr parasysh karakterin specifik të punës së OShC've. Për më tepër, OShC'të i plotësojnë kushtet për të aplikuar për licencim në shërbimet e caktuara sociale, bazuar në standardet e përcaktuara. Licencat janë parakusht për të aplikuar për ofrimin e shërbimeve



përkatëse dhe kjo vlenë edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve, përveç ofruesëve shtetëror të shërbimeve.

### Praktika

Në Kosovë, pak OShC janë të angazhuara në shërbime të ndryshme të cilat mbulohen nga fondet shtetërore, ndërsa shumica prej të angazhuarave janë të pranishme në fushën e shërbimeve sociale. Shumica e shërbimeve të ofruara nga shoqëria civile ende financohen nga donatorët ndërkombëtarë. Vetëm 7.9% e OShC've të anketuara aplikuan për kontrata shtetërore gjatë vitit 2016, ndërsa më pak se gjysma e tyre gëzoi dhënien e kontratës. Vetëm disa OShC përfshihen në fazat e ndryshme të shërbimeve në zhvillim dhe përfshirja e tyre e plotë në tërë ciklin prej planifikimit deri në vlerësim akoma mbetet prapa. Në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, vetëm OShC'të që kanë përfunduar procesin e licencimit për shërbimet përkatëse i plotësojnë kushtet për të fituar kontrata shtetërore për shërbime të tilla. Prosesi dhe kërkesat e licencimit janë të barabarta me të gjitha llojet e ofruesve të shërbimeve.

## Shtojca 1 – Burimet e shfrytëzuara

1. Kushtetuta e Kosovës
2. Ligji 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ'të
3. Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (përfshirë Ligjin 04/L-102 për ndryshimin e Ligjit 03/L-222)
4. Ligji 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit
5. Ligji 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe financimin e terrorizmit (Përfshirë Ligjin 04/L-178 për ndryshimin e Ligjit 03/L-196)
6. Ligji 03/L-162 për Tatimin në Të Ardhurat e Korporatave (përfshirë Ligjin 04/L-103 për ndryshimin e Ligjit 03/L-162)
7. Ligji 05/L-029 për Tatimin në Të Ardhurat e Korporatave
8. Ligji 03/L-161 për Tatimin në Të Ardhurat Personale (përfshirë Ligjin 04/L-104 për ndryshimin e ligjit 03/L-161)
9. Ligji 05/L-028 për Tatimin në Të Ardhurat Personale
10. Ligji 03/L-118 për Tubimet Publike
11. Ligji 03/L-212 i Punës
12. Ligji 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
13. Ligji për Buxhetin e vitit 2016
14. Ligji 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik
15. Ligji 03-L/040 për Vetëqeverisjen Lokale
16. Ligji 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike
17. Ligji 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare
18. Vendimi Shpjegues Publik 06/2016 i Administratës Tatimore për trajtimin tatimor të donacioneve
19. Rregullorja 05/2016 për Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik
20. Udhëzimi Administrativ QRK – Nr: 02/2014 për regjistrimin dhe funksionimin e OJQ've
21. Deklarata për partneritet ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shoqërisë Civile
22. Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017
23. Modeli Qeveritar për Financim Publik
24. Raporti i Qeverisë për Financim Publik për Periudhën 2015-2016
25. Plani Vjetor i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 për vitin 2016
26. Raporti i KE për Kosovën 2016

27. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (në rast kërkesë ofrohen të dhënat)
28. Puls i Publik UNDP, Vëllimi XI, Maj 2016
29. Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2008, Shoqëria Civile & Zhvillimi, UNDP
30. Matrica e Monitorimit mbi Krijimin e Mjedisit të Favorshëm për Zhvillimin e Shoqërisë Civile- Raporti për Kosovën 2014, 2014, 2015
31. Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, KCSF 2016



## Shtojca 2 – Lista e të intervistuarve

1. Adile Shaqiri – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
2. Afrim Maliqi – Handikos
3. Agron Gashi – Zyra Ligjore, Zyra e Kryeministrit
4. Arben Krasniqi – Sekretariati Koordinues i Qeverisë
5. Ares Shporta – Fondacioni Lumbardhi
6. Dardan Kryeziu – Platforma CiviKos
7. Flutura Blakçori – Njësia për Inteligjencë Financiare
8. Mehmet Musaj – Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
9. Muharrem Shahini – Ministria e Financave
10. Naime Sherifi – Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve
11. Sami Salihu – Administrata Tatimore e Kosovës
12. Trëndelinë Dreshaj – Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit
13. Veton Muja – Syri i Vizionit
14. Xhevat Bajrami – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit